



ALBANIAN

Basic Course

Volume IV

Lessons 37 - 46

January 1966

Revised June 1980

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE
FOREIGN LANGUAGE CENTER



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PREFACE

The Albanian Course, consisting of 120 lessons in 10 volumes, is one of the Defense Language Institute's Basic Course Series.

The course is designed to train native English language speakers to Level 3 proficiency in comprehending, speaking, reading and writing Albanian. The texts are intended for classroom use in the Defense Language Institute's intensive programs. Tapes accompany the texts.

This volume was revised in June 1980 to update factual information. Morphological, syntactical, and vocabulary changes were also made.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

CONTENTS

	Page
LESSON 37	
Grammar Perception Drill	2
Dialogue Number 37	6
Main Features: Possessive adjectives in nominative	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 37	8
Grammar Analysis: Adjectives: possessive adjectives	9
Grammar Drill	11
Translation Exercises	18
Reading Text and Questions	20
Homework	22
Vocabulary	23
LESSON 38	
Grammar Perception Drill	26
Dialogue Number 38	29
Main Features: Verbs: The present participle in contrast with the progressive: jam tue shkue-po shkoj, and the future. Conjugation of me ujitë (key: me matë). Conjugation of the passive verbs in perfect tense in contrast with the transitive verbs: jam lá-kam lá.	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 38	31
Grammar Analysis: 2nd form of the progressive (po shkoj- conjugation). Usage of the progressive and present participle in contrast with the English language. Compound tenses of the passive verbs.	32
Grammar Drill	36
Translation Exercises	41
Reading Text and Questions	43
Homework	45
Vocabulary	46

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 39

Grammar Perception Drill	50
Dialogue Number 39	54
Main Features: Verbs: Simple past of me thânë-me dhânë-me bâ. Negation mos.	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 39	56
Grammar Analysis: Negation of mos in contrast with nuk. Simple past of verbs ending in infinitive in nasals.	57
Grammar Drill	59
Translation Exercises	64
Reading Text and Questions	66
Homework	68
Vocabulary	69

LESSON 40

Grammar Perception Drill	72
Dialogue Number 40	74
Main Features: Verbs: Imperative with direct object. Present future and simple past-me matë. Nouns: Verbal nouns. Quasi compounds (continuation).	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 40	76
Grammar Analysis: Imperative with direct object. Verbal nouns ending in -im.	78
Grammar Drill	81
Translation Exercises	88
Reading Text and Questions	90
Homework	93
Vocabulary	94

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 41

Grammar Perception Drill	98
Dialogue Number 41	102
Main Features: Comparative and Superlative	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 41	104
Grammar Analysis: Comparative with adjectives. Superlative. Comparative with adverbs.	106
Grammar Drill	109
Translation Exercises	115
Reading Text and Questions	117
Homework	119
Vocabulary	120

LESSON 42

Grammar Perception Drill	124
Dialogue Number 42	127
Main Features: Verbs: Present and simple past: me hjekë, me nxjerrë, me rrjedhë, me sjellë. Present and simple past of unique key : me ndie. Present of unique key: me djegë. Preposition deri and derisa.	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 42	129
Grammar Analysis: Verbs ending in the infinitive in -jelë, -jellë, -edhë, -jerrë (conjugation of simple past). Verbs ending in the infinitive in -jekë and -jegë (conjugation of present and simple past). Verbs ending in the infinitive in -ie (conjugation of the simple past). Prepositions deri and derisa.	131
Grammar Drill	134
Translation Exercises	140
Reading Text and Questions	142
Homework	144
Vocabulary	145

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 43

Grammar Perception Drill	148
Dialogue Number 43	151
Main Features: Present, future and simple past of passive verbs: me u-rrue, me u-nisë, me u-çue as 1. reflexive; 2. as medio-passive; 3. with action of reciprocity; 4. as idiomatic passive.	
Idiomatic Translation of Dialogue 43	153
Grammar Analysis: Formation and conjugation of the passive verbs from active verbs. Usage of passive verbs.	155
Grammar Drill	161
Translation Exercises	167
Reading Text and Questions	169
Homework	171
Vocabulary	172

LESSON 44

Grammar Perception Drill	175
Dialogue Number 44	179
Main Features: Imperfect (type A) of passive verbs, (key verbs Lesson 43). Compound pronouns. Verb me u-largue versus me u-nisë.	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 44	181
Grammar Analysis: Formation of the imperfect (passive verbs) and conjugation. Compound pronouns. Usage of the verbs me u-largue and me u-nisë.	182
Grammar Drill	186
Translation Exercises	193
Reading Text and Questions	195
Homework	198
Vocabulary	199

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 45

Grammar Perception Drill	202
Dialogue Number 45	205
Main Features: Imperfect (type B) of the passive verbs. Irregular verbs: me lânë (present), me vû and me prû (present simple past and future). Admirative mood.	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 45	207
Grammar Analysis:	209
The admirative mood. The imperfect (type B) of the passive verbs.	
Grammar Drill	213
Translation Exercises	218
Reading Text and Questions	220
Homework	223
Vocabulary	224

LESSON 46

Grammar Perception Drill	226
Dialogue Number 46	229
Main Features: The 3rd person of the passive verbs. Fractions.	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 46	231
Grammar Analysis:	232
Passive verbs: usage of the 3rd person. Fractions.	
Grammar Drill	235
Translation Exercises	238
Reading Text and Questions	240
Homework	243
Vocabulary	244

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 37
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. A âsht ky libri juej?
Po, ai âsht libri im.
A âsht ky lapsi juej?
Po, ai âsht lapsi im.
A âsht ky rradhori juej?
Po, ai âsht rradhori im.
A âsht ky djali juej?
Po, ai âsht djali im.
A jam unë mësuesi juej?
Po, ju jeni mësuesi im.
A âsht ai shoku juej?
Po, ai âsht shoku im.
A âsht ai miku juej?
Po, ai âsht miku im.

2. A âsht kjo pënda juej?
Po, ajo âsht pënda ime.
A âsht kjo karriga juej?
Po, ajo âsht karriga ime.
A âsht kjo tryeza juej?
Po, ajo âsht tryeza ime.
A âsht kjo letra juej?
Po, ajo âsht letra ime.
A âsht kjo klasa juej?
Po, ajo âsht klasa ime.
A âsht kjo xhaketa juej?
Po, ajo âsht xhaketa ime.
A âsht kjo kapela juej?
Po, ajo âsht kapela ime.

3. A jam unë mësuesi juej?
Po, ju jeni mësuesi ynë.
Kush âsht mësuesi juej?
Ju jeni mësuesi ynë.
A âsht ai miku juej?
Po, ai âsht miku ynë.
Kush âsht miku juej?
Ai âsht miku ynë.
A âsht ai vllai juej?
Po, ai âsht vllai ynë.
Kush âsht vllai juej?
Ai âsht vllai ynë.
A âsht ai oficeri juej?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Po, ai âsht oficeri ynë.
A âsht ai mjeku juej?
Po, ai âsht mjeku ynë.
A âsht ai kushrîni juej?
Po, ai âsht kushrîni ynë.

4. A âsht ajo mësuesja juej?
Po, ajo âsht mësuesja jonë.
Kush âsht mësuesja juej?
Ajo âsht mësuesja jonë.
A âsht ajo infermierja juej?
Po, ajo âsht infermierja jonë.
A âsht ajo tezja juej?
Po, ajo âsht tezja jonë.
A âsht ajo shtëpija juej?
Po, ajo âsht shtëpija jonë.
A âsht ajo kompanija juej?
Po, ajo âsht kompanija jonë.
A âsht ajo kazerma juej?
Po, ajo âsht kazerma jonë.
A âsht kjo tryeza juej?
Po, ajo âsht tryeza jonë.

5. A âsht ky lapsi i tij?
Po, ai âsht lapsi i tij.
A âsht ky libri i tij?
Po, ai âsht libri i tij.
A âsht ky rradhori i tij?
Po, ai âsht rradhori i tij.
A âsht ky miku i tij?
Po, ai âsht miku i tij.
A âsht ky mësuesi i tij?
Po, ai âsht mësuesi i tij.
A âsht ky kushrîni i tij?
Po, ai âsht kushrîni i tij.

6. A âsht ajo vajza e tij?
Po, ajo âsht vajza e tij.
A âsht ajo mësuesja e tij?
Po, ajo âsht mësuesja e tij.
A âsht ajo tezja e tij?
Po, ajo âsht tezja e tij.
A âsht ajo nâna e tij?
Po, ajo âsht nâna e tij.
A âsht ajo tryeza e tij?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Po, ajo âsht tryeza e tij.
A âsht ajo karriga e tij?
Po, ajo âsht karriga e tij.
A âsht ajo letra e tij?
Po, ajo âsht letra e tij.
A âsht ajo fabrika e tij?
Po, ajo âsht fabrika e tij.

7. A âsht ai mësuesi i tyne?
Po, ai âsht mësuesi i tyne.
A âsht ai automobili i tyne?
Po, ai âsht automobili i tyne.
A âsht ai mjeku i tyne?
Po, ai âsht mjeku i tyne.
A âsht ai daja i tyne?
Po, ai âsht daja i tyne.
A âsht ai vllai i tyne?
Po, ai âsht vllai i tyne.
A âsht ai libri i tyne?
Po, ai âsht libri i tyne.
A âsht ai rradhori i tyne?
Po, ai âsht rradhori i tyne.

8. A âsht ajo mësuesja e tyne?
Po, ajo âsht mësuesja e tyne.
A âsht ajo tezja e tyne?
Po, ajo âsht tezja e tyne.
A âsht ajo motra e tyne?
Po, ajo âsht motra e tyne.
A âsht ajo infermierja e tyne?
Po, ajo âsht infermierja e tyne.
A âsht ajo tryeza e tyne?
Po, ajo âsht tryeza e tyne.

9. A janë ata oficerat tuej?
Po, ata janë oficerat e mij.
A janë ata mësuesit tuej?
Po, ata janë mësuesit e mij.
A janë ata kushrîjt tuej?
Po, ata janë kushrîjt e mij.
A janë ata vllaznit tuej?
Po, ata janë vllaznit e mij.
A janë ata miqt tuej?
Po, ata janë miqt e mij.
A janë ata fjalorët tuej?
Po, ata janë fjalorët e mij.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

10. A janë ata mësuesit e tyne?
Po, ata janë mësuesit e tyne.
A janë ata oficerat e tyne?
Po, ata janë oficerat e tyne.
A janë ata vllaznit e tyne?
Po, ata janë vllaznit e tyne.
A janë ata miqt e tyne?
Po, ata janë miqt e tyne.
A janë ata shokët e tyne?
Po, ata janë shokët e tyne.
A janë ata kushrîjt e tyne?
Po, ata janë kushrîjt e tyne.
A janë ata nxânsit e tyne?
Po, ata janë nxânsit e tyne.
A janë ata mjekët e tyne?
Po, ata janë mjekët e tyne.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 37
PART II
DIALOGUE

TE ÇIFLIKU I XHAJËS

1. Çë bâtë të dielen?
2. Shkova në fshat për t'u-pá me xhajën.

3. A ka çiflik xhaja juej?
4. Po, xhaja im ka nji çiflik të madh.

5. Çka mbjell ai në çiflik?
6. Mbjell misër, grunë, groshë dhe mban bagëti.

7. Çfarë bagëtish mban?
8. Mban lopë, dhen, dhí, kuaj dhe derra.

9. Po pemishtë dhe kopsht me zarzavate, a ka?
10. Po, në pemishtë ka molla, dardha, qershí, pjeshka etj.

11. Çka mbjell në kopsht?
12. Sallatë, domate, lakna, qepë, hudra, speca, kastraveca dhe patate.

13. Po shpendë shtëpijakë, a ka?
14. Po, ka pula, gjela, pula dhe gjela deti, pata, rosa etj.

15. Çë bân xhaja juej me prodhimet e tija?
16. Mban çka ka nevojë dhe tjerat i shet në pazár.

17. A ka bujq tjerë afër xhajës?
18. Po, krejt fshati merret me bujqësí.

19. Kush punon në çiflikun e xhajës?
20. Xhaja, djelmt e tij dhe grât e tyne.

21. A nuk ka punëtorë?
22. Vetëm në verë ka ca punëtorë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ALBANIAN 37



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School:

Idiomatic Translation - Përkëthim i Lirë

AT MY UNCLE'S FARM

1. What did you do last Sunday?
2. I went to the village to see my uncle.

3. Does your uncle have a farm?
4. Yes, he owns a big farm.

5. What does he plant on his farm?
6. He plants: corn, wheat, beans and raises livestock.

7. What kind of livestock does he raise?
8. He raises: cows, sheep, goats, horses and hogs.

9. Does he have orchards and vegetable gardens?
10. Yes, he has an orchard planted with apple trees, pear trees, cherry trees, peach trees, etc.

11. What does he plant in the vegetable garden?
12. Lettuce, tomatoes, cabbage, onions, garlic, peppers, cucumbers, potatoes, etc.

13. Does he keep any fowl?
14. Yes, he keeps chickens, roosters, (hen and tom) turkeys, geese and ducks.

15. What does your uncle do with his products?
16. He keeps for himself whatever he needs, and he sells the rest at the market place.

17. Are there other farmers close to your uncle's farm?
18. Yes, the whole village's occupation is agriculture.

19. Who works on your uncle's farm?
20. My uncle, his sons and their wives.

21. Doesn't he have workers?
22. He has some workers only during the summer.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

LESSON 37
PART III
GRAMMAR ANALYSIS

POSSESSIVE ADJECTIVES

In Albanian, (the) possessive adjectives follow the noun, which must usually be in the definite form. They are inflected in gender, number and case.

(a) Gender and Number--The possessive adjectives agree in gender, number and case with the "object" possessed and "not" with the possessor. Only in the third person singular the possessive adjective agrees with the possessor (djali i tij, djali i saj; vajza e tij, vajza e saj).

Examples:

When the object possessed is a singular masculine or feminine noun:

djali im	my son
vajza ime	my daughter
djali yt	thy son
vajza jote	thy daughter
djali i tij	his son
vajza e tij	his daughter
djali i saj	her son
vajza e saj	her daughter
djali ynë	our son
vajza jonë	our daughter
djali juej	your son
vajza juej	your daughter
djali i tyne	their son
vajza e tyne	their daughter

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

When the object possessed is a plural masculine or feminine noun:

djelmt e mij	my sons
vajzat e mija	my daughters
djelmt e tú	thy sons
vajzat e tua	thy daughters
djelmt e tij	his sons
vajzat e tija	his daughters
djelmt e saj	her sons
vajzat e saja	her daughters
djelmt tonë	our sons
vajzat tona	our daughters
djelmt tuej	your sons
vajzat tueja	your daughter
djelmt e tyne	their sons
vajzat e tyne	their daughters

(b) Case--All possessive adjectives used in this lesson are in the nominative case. Their declension will be the subject of study in other lessons.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 37
PART IV
GRAMMAR DRILL

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

1. A i mbaj unë librat e rradhorët në çantë?
Po, ju i mbani librat e rradhorët në çantë.
Ku i mban ti librat e rradhorët?
Unë i mbaj librat e rradhorët në çantë.
Kush i mban librat e rradhorët në çantë?
Zotni Preveza i mban librat e rradhorët në çantë.
A i mbajmë na rrobet në raft?
Po, na i mbajmë rrobet në raft.
Ku i mbani ju rrobet?
Na i mbajmë rrobet në raft.
Cilët i mbajnë rrobet në raft?
Ata i mbajnë rrobet në raft.

2. A i mbajshem unë librat në dorë kur ishem nxânës?
Po, kur ishi nxânës ju i mbajshi librat në dorë.
Ku i mbajshe ti librat kur ishe nxânës?
Kur ishem nxânës unë i mbajshem librat në dorë.
Kush i mbante librat në dorë kur ishte nxânës?
Ai i mbante librat në dorë kur ishte nxânës.
A i mbajshim na fëmijët në shtrat kur ishin të sëmundë?
Po, na i mbajshim fëmijët në shtrat kur ishin të sëmundë.
Ku i mbajshi ju fëmijët kur ishin të sëmundë?
Na i mbajshim fëmijët në shtrat kur ishin të sëmundë.
Cilët i mbajshin fëmijët në shtrat kur ishin të sëmundë?
Ata i mbajshin fëmijët në shtrat kur ishin të sëmundë.

3. A kushton shumë me shkue në San Francisco me autobus?
Jo, me shkue në San Francisco me autobus nuk kushton shumë.
Ku nuk kushton shumë me shkue me autobus?
Me shkue në San Francisco me autobus nuk kushton shumë.
Sa kushton me shkue në San Francisco me autobus?
Me shkue në San Francisco me autobus nuk kushton shumë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

4. A âsht i madh automobili juej?
Po, automobili im âsht i madh.
Automobili i kujt âsht i madh?
Automobili im âsht i madh.
Qysh âsht automobili juej?
Automobili im âsht i madh.
A âsht mësuesi juej shqiptár?
Po, mësuesi im âsht shqiptár.
Mësuesi i kujt âsht shqiptár?
Mësuesi im âsht shqiptár.
Çë kombësije âsht mësuesi juej?
Mësuesi im âsht shqiptár.
A âsht xhaja juej 37 vjeç?
Po, xhaja im âsht 37 vjeç.
Xhaja i kujt âsht 37 vjeç?
Xhaja im âsht 37 vjeç.
Sa vjeç âsht xhaja juej?
Xhaja im âsht 37 vjeç.
A âsht vllai juej nxânës?
Po, vllai im âsht nxânës.
Vllai i kujt âsht nxânës?
Vllai im âsht nxânës.
Çka âsht vllai juej?
Vllai im âsht nxânës.

A âsht e bukur shtëpija juej?
Po, shtëpija ime âsht e bukur.
Shtëpija e kujt âsht e bukur?
Shtëpija ime âsht e bukur.
Qysh âsht shtëpija juej?
Shtëpija ime âsht e bukur.
A âsht e ré çanta juej?
Po, çanta ime âsht e ré.
Çanta e kujt âsht e ré?
Çanta ime âsht e ré.
Qysh âsht çanta juej?
Çanta ime âsht e ré.
A âsht e madhe dritorja juej?
Po, dritorja ime âsht e madhe.
Dritorja e kujt âsht e madhe?
Dritorja ime âsht e madhe.
Qysh âsht dritorja juej?
Dritorja ime âsht e madhe.
A âsht mësuesja juej shqiptare?
Po, mësuesja ime âsht shqiptare.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Mësuesja e kujt âsht shqiptare?
Mësuesja ime âsht shqiptare.
Çë kombësije âsht mësuesja juej?
Mësuesja ime âsht shqiptare.

5. A banojnë prindët tuej në Virgjinia?
Jo, prindët e mij nuk banojnë në Virgjinia.
Prindët e kujt nuk banojnë në Virgjinia?
Prindët e mij nuk banojnë në Virgjinia?
Ku nuk banojnë prindët tuej?
Prindët e mij nuk banojnë në Virgjinia.
A dijnë me folë shqip fëmijët tuej?
Jo, fëmijët e mij nuk dijnë me folë shqip.
Fëmijët e kujt nuk dijnë me folë shqip?
Fëmijët e mij nuk dijnë me folë shqip.
Cilët fëmijë nuk dijnë me folë shqip?
Fëmijët e mij nuk dijnë me folë shqip.
A janë librat tuej përdhé?
Jo, librat e mij nuk janë përdhé.
Librat e kujt nuk janë përdhé?
Librat e mij nuk janë përdhé.
Ku nuk janë librat tuej?
Librat e mij nuk janë përdhé.
A janë vllaznit tuej nënoficera?
Jo, vllaznit e mij nuk janë nënoficera.
Vllaznit e kujt nuk janë nënoficera?
Vllaznit e mij nuk janë nënoficera.
Çka nuk janë vllaznit tuej?
Vllaznit e mij nuk janë nënoficera.

A janë këpucët tueja të zeza?
Po, këpucët e mija janë të zeza.
Këpucët e kujt janë të zeza?
Këpucët e mija janë të zeza.
Çfarë ngjyre kanë këpucët tueja?
Këpucët e mija janë të zeza.
A shkruejnë mirë pêndat tueja?
Po, pêndat e mija shkruejnë mirë.
Pêndat e kujt shkruejnë mirë?
Pêndat e mija shkruejnë mirë.
Qysh shkruejnë pêndat tueja?
Pêndat e mija shkruejnë mirë.
A janë të bardha këmishat tueja?
Po, këmishat e mija janë të bardha.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

Këmishat e kujt janë të bardha?
Këmishat e mija janë të bardha.
Çfarë ngjyre janë këmishat tueja?
Këmishat e mija janë të bardha.
A janë shqiptare mësueset tueja?
Po, mësueset e mija janë shqiptare.
Mësueset e kujt janë shqiptare?
Mësueset e mija janë shqiptare.
Çë kombësije janë mësueset tueja?
Mësueset e mija janë shqiptare.

For further practice reverse questions and answers in 4 and 5.

6. A âsht Zotní Drîni rrobaqepës?
Po, Zotní Drîni âsht rrobaqepës.
Kush âsht rrobaqepës?
Zotni Drîni âsht rrobaqepës.
Me çka merret Zotní Drîni?
Zotni Drîni âsht rrobaqepës.
Çka âsht Zotní Drîni?
Zotní Drîni âsht rrobaqepës.
A âsht dyqani i tij në Rrugën Kosova?
Po, dyqani i tij âsht në Rrugën Kosova.
Dyqani i kujt âsht në Rrugën Kosova?
Dyqani i tij âsht në Rrugën Kosova.
Në çë rrugë âsht dyqani i tij?
Dyqani i tij âsht në Rrugën Kosova.

A âsht Zotní Tabaku nga Tirana?
Po, Zotní Tabaku âsht nga Tirana.
Kush âsht nga Tirana?
Zotní Tabaku âsht nga Tirana.
Prej nga âsht Zotní Tabaku?
Zotní Tabaku âsht nga Tirana.
A âsht grueja e tij nga Kavaja?
Po, grueja e tij âsht nga Kavaja.
Kush âsht nga Kavaja?
Grueja e tij âsht nga Kavaja.
Prej nga âsht grueja e tij?
Grueja e tij âsht nga Kavaja.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A do të shkojë nesër në plazhë Zotni Bregu?
Po, Zotni Bregu do të shkojë nesër në plazhë.
Kush do të shkojë nesër në plazhë?
Zotni Bregu do të shkojë nesër në plazhë.
Ku do të shkojë nesër Zotni Bregu?
Zotni Bregu do të shkojë nesër në plazhë.
A do të shkojnë edhe djelmt e tij në plazhë?
Po, edhe djelmt e tij do të shkojnë në plazhë.
Ku do të shkojnë edhe djelmt e tij?
Edhe djelmt e tij do të shkojnë në plazhë.
Edhe djelmt e kujt do të shkojnë në plazhë?
Edhe djelmt e tij do të shkojnë në plazhë.
Po vajzat e tija, a do të shkojnë?
Jo, vajzat e tija nuk do të shkojnë.
Vajzat e kujt nuk do të shkojnë?
Vajzat e tija nuk do të shkojnë.
Ku nuk do të shkojnë vajzat e tija?
Vajzat e tija nuk do të shkojnë në plazhë.

7. A âsht mësuesi ynë nga Durrsi?
Po, mësuesi ynë âsht nga Durrsi.
Mësuesi i kujt âsht nga Durrsi?
Mësuesi ynë âsht nga Durrsi.
Prej nga âsht mësuesi ynë?
Mësuesi ynë âsht nga Durrsi.
Kush âsht nga Durrsi?
Mësuesi ynë âsht nga Durrsi.

A âsht e madhe shkolla jonë?
Po, shkolla jonë âsht e madhe.
Shkolla e kujt âsht e madhe?
Shkolla jonë âsht e madhe.
Qysh âsht shkolla jonë?
Shkolla jonë âsbt e madhe.

A janë librat tonë në raftin e libravet?
Po, librat tonë janë në raftin e libravet.
Librat e kujt janë në raftin e libravet?
Librat tonë janë në raftin e libravet.
Ku janë librat tonë?
Librat tonë janë në raftin e libravet.
Në cilin raft janë librat tonë?
Librat tonë janë në raftin e libravet.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A janë të reja karrigat tona?
Po, karrigat tona janë të reja.
Karrigat e kujt janë të reja?
Karrigat tona janë të reja.
Cilat karriga janë të reja?
Karrigat tona janë të reja.
Qysh janë karrigat tona?
Karrigat tona janë të reja.

8. A ka shtëpija e tyne 6 dhoma?
Po, shtëpija e tyne ka 6 dhoma.
Shtëpija e kujt ka 6 dhoma?
Shtëpija e tyne ka 6 dhoma.
Sa dhoma ka shtëpija e tyne?
Shtëpija e tyne ka 6 dhoma.
Cila shtëpí ka 6 dhoma?
Shtëpija e tyne ka 6 dhoma.

A âsht vllai i tyne mësues?
Po, vllai i tyne âsht mësues.
Vllai i kujt âsht mësues?
Vllai i tyne âsht mësues.
Çka âsht vllai i tyne?
Vllai i tyne âsht mësues.
Kush âsht mësues?
Vllai i tyne âsht mësues.

A janë shtëpít e tyne mbi nji kodër?
Po, shtëpít e tyne janë mbi nji kodër.
Shtëpít e kujt janë mbi nji kodër?
Shtëpít e tyne janë mbi nji kodër.
Ku janë shtëpít e tyne?
Shtëpít e tyne janë mbi nji kodër.
Cilat shtëpí janë mbi nji kodër?
Shtëpít e tyne janë mbi nji kodër.

A janë vllaznit e tyne nxânës?
Po, vllaznit e tyne janë nxânës.
Vllaznit e kujt janë nxânës?
Vllaznit e tyne janë nxânës.
Çka janë vllaznit e tyne?
Vllaznit e tyne janë nxânës.
Cilët vllazën janë nxânës?
Vllaznit e tyne janë nxânës.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

9. A janë drithna gruni dhe misri?
Po, gruni dhe misri janë drithna.
Çka janë gruni dhe misri?
Gruni dhe misri janë drithna.

A janë pemë dardha e pjeshka?
Po, dardha e pjeshka janë pemë.
Çka janë dardha e pjeshka?
Dardha e pjeshka janë pemë.

A janë zarzavate specat, domatet e kastravecat?
Po, specat, domatet e kastravecat janë zarzavate.
Çka janë specat, domatet e kastravecat?
Specat, domatet e kastravecat janë zarzavate.

A janë shpendë rosa, pula e gjeli i detit?
Po, rosa, pula e gjeli i detit janë shpendë.
Çka janë rosa, pula e gjeli i detit?
Rosa, pula e gjeli i detit janë shpendë.

A kemi grá në këtë klasë?
Jo, në këtë klasë nuk kemi grá.
Në cilën klasë nuk kemi grá?
Në këtë klasë nuk kemi grá.
Çka nuk kemi në këtë klasë?
Në këtë klasë nuk kemi grá.

A punon grueja juej?
Po, grueja ime punon.
Grueja e kujt punon?
Grueja ime punon.
Kush punon?
Grueja ime punon.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 37
PART V

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

TRANSLATION EXERCISE

1. Më vjen keq që sot nuk mund të shkojmë me bâ nji shetí në kodër, ashtu si e kemi zakon çdo të diele mbasdreke; arsyeja âsht se bân të ftofët dhe âsht gati me rá shí. Në qoftë se koha âsht e mirë do të shkojmë të dielen që vjen.
2. Ka kohë që nuk i kam pá prindët. Ata më shkruejnë sot se kanë ndërmend me ardhë këtu për pushimet e Krishtlindjevet. Baba më thotë se ka qenë i ftofun gjithë këtë javë. Nâna âsht bâ merak; thotë se baba lodhet shumë nga puna, megjithëqë nuk punon mâ shumë se përpara. Ajo nuk e kupton se baba nuk âsht i rí si përpara.
3. Në mëngjes nisem me tren n'orën 7.15 dhe mrrîj në shkollë tamam kur fillon mësimi. Deri tash treni s'ka pasë kurr vonesë. Treni ndalet në dý stacione.
4. Shtëpija që bleva këto kohët e fundit ka nji kopsht mjaft të madh; âsht 30 m. i gjatë dhe 25 m. i gjânë. Në pranverë do të mbjell lule të ndryshme. Ka trí pemë: nji qershí, nji mollë dhe nji portokall.
5. Nuk e dij pse, por ka dý ditë që kur marr frymë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

më dhemb diçka në gjoks. Besoj se nuk âsht asgjâ serioze, por megjithatë mendoj me shkue ke mjeku.

6. Gjergji më tha se ka humbë librat. A mos e dini ju ku i ka harrue?

My uncle is a farmer. His farm is not far from Tirana. On Saturdays and Sundays I go to my uncle's farm to spend some time. Usually, I go by bus, but once in a while I go by car. When I go there, I work hard from morning until night. There is a lot of work to be done, especially during the spring.

My uncle plants wheat, corn, barley, oats and vegetables. Near his home he has a beautiful orchard of fruit trees. My uncle, his sons and their wives work on the farm; only my aunts stay home to prepare the meals (me bâ me hangër). My uncle keeps the products he needs and sells the rest at the market. From the orchard he keeps apples, pears, peaches and cherries for the family, and what he doesn't need he sells at the market. As soon as they are ready for harvesting, he sells the salad greens, potatoes, onions, garlic, cantaloups, cucumbers and green peppers. These are products that he cannot keep too long. He keeps a lot of potatoes as pig food.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

LESSON 37
PART VI
READING TEXT

Proverb: Pa punë as anmikun mos e pafsh!

Të dielen që kaloi shkova me u-pá me xhajën. Xhaja jeton në fshat; atje ka nji çiflik të madh. Xhaja âsht i martuem dhe ka katër djelm. Djali i madh âsht 28 vjeç e djali më i vogël âsht 22 vjeç. Të gjithë djelmt e xhajës janë të martuem. Xhaja dhe djelmt e tij punojnë tokën, d.m.th. janë bujq. Afër xhajës jetojnë edhe shumë bujq tjerë. Zakonisht, xhaja mbjell në çiflikun e tij grunë, misër e tërshanë. Para shtëpís ka nji kopsht me zarzavate. Ka edhe nji pemishtë me dardha, molla, pjeshka, qershí etj. Përveç këtyne, familja e xhajës mban edhe mjaft pula, gjela, rika e bagëtí. Xhaja ka në çiflikun e tij edhe gjashtë kuaj e trí mushka. Mban edhe mjaft derra.

Xhaja dhe djelmt e tij, mbasi mbajnë për vete prodhimet që u nevojiten, tepricën e dërgojnë për t'a shitë në pazár.

QUESTIONS - PYETJE

1. Me kë shkova me u-pá të dielen që kaloi?
2. Kur shkova me u-pá me xhajën?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

3. Ku jeton xhaja?
4. Kush jeton në fshat, ku ka nji çiflik të madh?
5. Kush âsht i martuem dhe ka katër djelm?
6. Sa vjeç âsht djali i madh?
7. Cili djalë âsht 28 vjeç?
8. Po djali më i vogël, sa vjeç âsht?
9. Cili djalë âsht 22 vjeç?
10. Djelmt e kujt janë të martuem?
11. Çka punojnë xhaja e djelmt e tij?
12. Cilët janë bujq?
13. Ku jetojnë edhe shumë bujq tjerë?
14. Kush mbjell në çiflikun e tij zakonisht grunë, misër e tërshanë?
15. Çka mbjell xhaja zakonisht në çiflikun e tij?
16. Ku ka nji kopsht me zarzavate?
17. Kush ka edhe nji pemishtë me dardha, molla etj?
18. Familja e kujt mban edhe mjaft pula, rika, bagëtí e dhen?
19. Çka mban familja e xhajës?
20. Kush ka edhe gjashtë kuaj e trí mushka?
21. Sa derra mban?
22. Çka i bâjnë prodhimet që nuk u nevojiten?
23. Ku i dërgojnë për t'i shitë prodhimet që nuk u nevojiten?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 37
PART VII
HOMEWORK

PJESA E SHTATË
DETYRË SHTËPIJE

Translate into Albanian.

1. My pen costs 25 leks.
2. Our classroom has two windows.
3. His teacher has been my teacher for two years.
4. Your children are playing in the yard.
5. Her daughter doesn't speak Albanian.
6. His uncle is very rich.
7. Their house is pretty big.
8. Your (fam. form) desk is large.
9. Your (fam. form) pencil is blue.
10. Your daughter and my son went to the city.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 37
PART VIII
VOCABULARY

PJESA E TETË
FJALORI

bagëti, -ja bagëti, -t	(f.)	cattle, livestock
çiflik, -u çifliqe, -t	(m.)	farm, estate
dardhë, -a dardha, -t	(f.)	pear (fruit and tree)
derr, -i derra, -t	(m.)	hog, pig
domate, domatja domate, -t	(f.)	tomatoe
dhen, -t	(f.pl.)	sheep (flock of sheep, rams, lambs)
dhí, -ja dhí, -t	(f.)	goat
fshat, -i fshatra, -t	(m.)	village
groshë, -a groshë, -t	(f.)	bean
grunë, -i	(m.)	wheat
hudër, hudra hudra, -t	(f.)	garlic
kastravec, -i kastraveca, -t	(m.)	cucumber
kopsht, -i kopshte, -t	(m.)	garden, yard
lakën, lakna lakna, -t	(f.)	cabbage

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me mbjellë (unë mbjell)	(v.)	to plant, sow
misër, misri misra, -t	(m.)	corn, maize
mushkë, -a mushka, -t	(f.)	mule
me u-pá (unë shifem)	(v.)	to be seen, meet
patate, patatja patate, -t	(f.)	potatoe
pemishtë, -a pemishte, -t	(f.)	orchard
pjeshkë, -a pjeshka, -t	(f.)	peach
qepë, -a qepë, -t	(f.)	onion
rosë, -a rosa, -t	(f.)	duck
sallatë, -a sallata, -t	(f.)	salad, lettuce, salad greens
spec, -i speca, -t	(m.)	green or red pepper, paprika
shpend, -i shpendë, -t	(m.)	fowl, feathered game
shtëpijak, -e shtëpijakë	(adj. m.&f.)	domestic
tepricë, -a teprica, -t	(f.)	leftover, remainder, balance
tërshanë, -a	(f.)	oats

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

xhajë, -a xhaja, -t	(m.)	uncle (on father's side)
zarzavate, -t	(f.pl.)	vegetable

NOTES:

me u-bâ merak (unë bâhem merak)	(v.)	to worry

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 38
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. A e nxêni mësimin tue shkue në shkollë?
Jo, unë nuk e nxâ mësimin tue shkue shkollë.
A shkoni në klasë tue hangër bukë?
Jo, unë nuk shkoj në klasë tue hangër bukë.
A e kaloni mbrâmjen tue lexue?
Po, unë e kaloj mbrâmjen tue lexue.
A e kalon nxânsi mbrâmjen tue studjue?
Po, nxânsi e kalon mbrâmjen tue studjue.
Si e kalon nxânsi mbrâmjen?
Nxânsi e kalon mbrâmjen tue studjue.
A e kalon nxânsi mbrâmjen tue nxânë?
Po, nxânsi e kalon mbrâmjen tue nxânë.
Si e kalon nxânsi mbrâmjen?
Nxânsi e kalon mbrâmjen tue nxânë.
A e kalon punëtori ditën tue punue?
Po, punëtori e kalon ditën tue punue.
Si e kalon ditën punëtori?
Punëtori e kalon ditën tue punue.
A e kalon fëmija ditën tue qâ?
Jo, fëmija nuk e kalon ditën tue qâ.
A e kalon vajza kohën tue lexue?
Po, vajza e kalon kohën tue lexue.
Si e kalon kohën vajza?
Vajza e kalon kohën tue lexue.

2. Ku jeni tue shkue?
Jam tue shkue në shkollë.
Ku po shkoni?
Po shkoj në shkollë.
Çka jeni tue lexue?
Jam tue lexue nji libër.
Çka po lexoni?
Po lexoj nji libër.
Çka jeni tue nxânë?
Jam tue nxânë dialogun.
Çka po nxêni?
Po nxâ dialogun.
Çka jeni tue bâ?
Jam tue nxânë dialogun.
Çka po bâni?
Po nxâ dialogun.
Çka âsht tue bâ mësuesi?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Mësuesi âsht tue mësue.
Çka po bân mësuesi?
Mësuesi po mëson.
Çka âsht tue bâ nxânsi?
Nxânsi âsht tue nxânë.
Çka po bân nxânsi?
Nxânsi po nxên.
Çka âsht tue bâ vajza?
Vajza âsht tue folë me mësuesen.
Çka po bân vajza?
Vajza po flet me mësuesen.
Çka âsht tue bâ oficeri?
Oficeri âsht tue folë me ushtarët.
Çka po bân oficeri?
Oficeri po flet me ushtarët.

3. A e keni lá automobilin dje?
Po, e kam lá.
A jeni lá ju dje?
Po, jam lá.
A e kam zgjue unë djalin heret sot?
Po, ju e keni zgjue djalin heret sot.
A jam zgjue edhe unë heret?
Po, edhe ju jeni zgjue heret.
A e kanë pastrue ata dhomën?
Po, ata e kanë pastrue dhomën.
A janë pastrue edhe ata vetë?
Po, edhe ata vetë janë pastrue.

4. Kush âsht lá me ujë të ftofët?
Unë jam lá me ujë të ftofët (ti, ai etj.).
Kush âsht çue heret sot?
Unë jam çue heret sot (ti, ai etj.).
Kush âsht nisë dje vetëm?
Unë jam nisë dje vetëm (ti, ai etj.).
Kush nuk âsht rrue dje?
Unë nuk jam rrue dje (ti, ai etj.).

5. A jeni lá ndonjiherë në liqê?
Po, unë jam lá shpeshherë në liqê.
Po vllai, a âsht lá ndonjiherë në liqê?
Po, edhe vllai âsht lá shpeshherë në liqê.
A jeni lá ndonjiherë në dét?
Po, na jemi lá shpeshherë në dét.
Po mësuesit, a janë lá ndonjiherë në dét?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Po, edhe mësuesit janë lá shpeshherë në dét.
A janë lá ushtarët ndonjiherë në liqê?
Po, ushtarët janë lá shpeshherë në liqê.
Po nxânsit, a janë lá shpeshherë në liqê?
Po, edhe nxânsit janë lá shpeshherë në liqê.

6. A je zgjue heret sot në mëngjes?
Po, unë jam zgjue heret sot në mëngjes.
Po kapiteni, a âsht zgjue heret sot në mëngjes?
Po, edhe kapiteni âsht zgjue heret sot në mëngjes.
A jeni zgjue heret ju të gjithë?
Po, na të gjithë jemi zgjue heret.
A janë zgjue heret ushtarët?
Po, ushtarët janë zgjue heret.
Kur janë zgjue ushtarët?
Ushtarët janë zgjue heret.
Kur janë zgjue nxânsit?
Nxânsit janë zgjue heret.
A janë zgjue mësuesit vonë?
Po, mësuesit janë zgjue vonë.
Kur janë zgjue mësuesit?
Mësuesit janë zgjue vonë.
Po mësueset, kur janë zgjue?
Edhe mësueset janë zgjue vonë.
Kur janë zgjue fëmijët?
Fëmijët janë zgjue heret.

7. A i mat rrobet para se t'i blejsh?
Po, unë i mas rrobet para se t'i blej.
A i mat mësuesi këpucët para se t'i blejë?
Po, mësuesi i mat këpucët para se t'i blejë.
A i matni çorapët para se t'i bleni?
Jo, na nuk i masim çorapët para se t'i blejmë.
A i masin grát kapelat para se t'i blejnë?
Po, grát i masin kapelat para se t'i blejnë.
A i masin vajzat fanelat para se t'i blejnë?
Po, vajzat i masin fanelat para se t'i blejnë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 38
PART II
DIALOGUE

PJESA E DYTË
DIALOGU

PUSHIMET NË LIQENIN E OHRIT

1. Kur do të niseni për pushime, Zotni Bakalli?
2. Nesër, shpresoj; ka nji vjet që po e pres këtë ditë.

3. Ku do të shkoni sivjet?
4. Në Pogradec.

5. Përsërí? A nuk jeni mërzitë tue shkue çdo vjet në të njâjtin vend?
6. A nuk e dini se Pogradeci âsht qendër verimi dhe ka klimë të shëndoshët?

7. S'kam qenë kurr atje, nuk e dij.
8. Përveç kësaj, fëmijët e mij nuk duen me shkue tjetërkund, veçse atje.

9. Pse vallë?
10. Kanë shoqní atje, fusha me bredhë, liqênin me notue etj.

11. Si do t'a kaloni kohën ju?
12. Tue fjetë e tue zânë peshk.

13. A ka peshk të mirë liqêni i Ohrit?
14. Po, ka nji lloj trofte që quhet koran.

15. Kam hangër koran; ka mish shumë të shijshëm.
16. Ashtu âsht; ky peshk jeton vetëm n'at liqê.

17. Me çka e zêni: me grep, apo me rrjetë?
18. E zâ me grep, natyrisht; rrjetën e përdorin peshkatarët.

19. Sa kohë do të qëndroni atje?
20. Mendoj të qëndrojmë vetëm nji muej; aq kam leje.

21. Kush do të kujdesohet për kopshtin do te thahet në qoftë se nuk e ujitni.
22. Vjehrra ime; ajo do të mendojë gjithashtu me u dhânë me hangër qenit e macës.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ALBANIAN-38



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 38
PART II

PJESA E DYTË
DIALOGU

DIALOGUE

Idiomatic Translation - Përkëthim i Lirë

VACATIONING AT LAKE OCHRIDA

1. When are you leaving for your vacation Mr. Bakalli?
2. Tomorrow, I hope. I have been waiting a year for this day.

3. Where are you going this year?
4. To Pogradec.

5. Again? Aren't you tired of going every year to the same place?
6. Don't you know that Pogradec is a vacation center and it has a healthy climate?

7. I've never been there, I don't know.
8. Besides (this), my children don't want to go anywhere else (but there).

9. I wonder why?
10. There they have company, open fields to wander in, the lake to swim in, etc.

11. How are you going to spend the time?
12. Sleeping and fishing.

13. Does Lake Ochrida have good fish?
14. Yes, there is a kind of trout called "koran."

15. I've eaten "koran," its meat is very tasty.
16. That's right, this fish lives only in that lake.

17. How do you catch it, with a fishhook or a net?
18. With a fishhook naturally, fishermen use nets.

19. How long will you stay there?
20. I think we'll stay only one month, that's the amount of leave I have.

21. Who's going to take care of your yard? It's going to dry out if you don't water it.
22. My mother-in-law, she'll feed the dog and also the cat.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 38
PART III

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

GRAMMAR ANALYSIS

THE PROGRESSIVE FORM OF THE PRESENT

1. We have already dealt with the progressive form of the present (see Vol. III, page 129), which is one of the two progressive forms of the Albanian verb. The second one is formed with the particle po and the present tense of the verb we want to use.

Examples:

me shkue

1st form		2nd form
jam tue shkue	(I am going)	po shkoj
je tue shkue	(you are going)	po shkon
âsht tue shkue	(he is going)	po shkon
jemi tue shkue	(we are going)	po shkojmë
jeni tue shkue	(you are going)	po shkoni
janë tue shkue	(they are going)	po shkojnë

me fjetë

jam tue fjetë	(I am sleeping)	po flêj
je tue fjetë	(you are ")	po flên
âsht tue fjetë	(he is ")	po flên
jemi tue fjetë	(we are ")	po flêjmë
jeni tue fjetë	(you are ")	po flêni
janë tue fjetë	(they are ")	po flêjnë

me bâ

jam tue bâ	(I am doing)	po bâj
je tue bâ	(you are doing)	po bân
âsht tue bâ	(he is doing)	po bân
jemi tue bâ	(we are doing)	po bâjmë
jeni tue bâ	(you are doing)	po bâni
janë tue bâ	(they are doing)	po bâjnë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me thânë

jam tue thânë	(I am saying)	po thom
je tue thânë	(you are saying)	po thue
âsht tue thânë	(he is saying)	po thotë
jemi tue thânë	(we are saying)	po thomi
jeni tue thânë	(you are saying)	po thoni
janë tue thânë	(they are saying)	po thonë

2. Note that the present progressive may extend the meaning to include what happens habitually in the present, even though the action is not happening at the present moment.

Examples:

Janë tue ndërtue (or: po ndërtojnë) shumë shtëpí të bukura këto kohët e fundit.

(They are building beautiful houses nowadays.)

Fëmijët e mij janë tue shkue (or: po shkojnë mirë me mësime).

(My children are getting along fine at school.)

Remark: The two forms of the progressive are used interchangeably without change in content. However, to give the content a sense of urgency, the form with po is used.

Examples:

Agim: Eja se u-bâ vonë!
(Agim: Come on, it's getting late.)

Tefta: Po vîj.
(Tefta: I am coming (right now).)

Agim: A shkove atje?
(Agim: Did you go there?)

Tefta: Jo, po shkoj tash.
(Tefta: No, I am going right now.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

3. The first form has its participle; the second one does not.

Examples:

tue shkue	going
tue bâ	doing
tue fjetë	sleeping
tue thânë	saying

4. Since English verbal nouns and participles are the same in form, the student learning Albanian makes the common mistake of applying the same rule of sameness in form to Albanian verbal nouns and participles. The English verbal noun may correspond to a completely different category in Albanian.

Examples:

Reading is useful. (verbal noun subject)
Leximi âsht i nevojshëm. (verbal noun)

She prefers walking. (verbal noun object)
Asaj i pëlqen me ecë. (infinitive)

He remained sitting. (attribute)
Ai ndejti ulë. (past participle)

How about going? (object of preposition)
Po në qoftë se shkojmë? (present tense)

Other expressions like "I am going to leave tomorrow" are translated in Albanian with the verb in the future: Nesër do të nisem.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

COMPOUND TENSES OF PASSIVE VERBS

Compound tenses of passive verbs are conjugated with the auxiliary me genë "to be."

Examples:

me u-lá	me u-këthye	me u-zgjue
jam lá	jam këthye	jam zgjue
je lá	je këthye	je zgjue
âsht lá	âsht këthye	âsht zgjue
jemi lá	jemi këthye	jemi zgjue
jeni lá	jeni këthye	jeni zgjue
janë lá	janë këthye	janë zgjue

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 38
PART IV
GRAMMAR DRILL

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

1. A e ujis unë kopshtin çdo ditë?
Jo, ju nuk e ujitni kopshtin çdo ditë.
Çka ujit ti dý herë në javë?
Unë ujis kopshtin dý herë në javë.
Kush nuk e ujit kurr kopshtin?
Nuk e dij kush nuk e ujit kurr kopshtin.
Çka bâjmë na shpesh?
Na e ujisim kopshtin shpesh.
Kur e ujitni ju kopshtin?
Na e ujisim kopshtin në mëngjes.
Cilët e ujisin kopshtin në mbrâmje?
Ata e ujisin kopshtin në mbrâmje.

2. A i futa unë të hollat në xhep?
Po, ju i futët të hollat në xhep.
Ku i fute ti të hollat?
Unë i futa të hollat në xhep.
Kush nuk i futi të hollat në xhep?
Ai nuk i futi të hollat në xhep.
A i futëm na të hollat në çantë?
Po, na i futëm të hollat në çantë.
Ku i futët ju të hollat?
Na i futëm të hollat në çantë.
Cilët i futën të hollat në çantë?
Ata i futën të hollat në çantë.

3. A do të fus unë shumë gjâna në raft?
Po, ju do të futni shumë gjâna në raft.
Çka do të fusish ti në raft?
Unë do të fus shumë gjâna në raft.
Kush do të fusi shumë gjâna në raft?
Ai do të fusi shumë gjâna në raft.
A do t'i fusim na rrobet në raft?
Po, na do t'i fusim rrobet në raft.
Çka do të futni ju në raft?
Na do t'i fusim rrobet në raft.
Cilët do t'i fusin rrobet në raft?
Shokët e mij do t'i fusin rrobet në raft.

4. A e kaloj unë kohën tue shkrue letra?
Po, ju e kaloni kohën tue shkrue letra.
Qysh e kalon ti kohën?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Unë e kaloj kohën tue lexue.
Kush e kalon kohën tue lexue e tue shkrue letra?
Ai e kalon kohën tue lexue e tue shkrue letra.
A e kalojmë na kohën tue punue e tue lexue?
Po, na e kalojmë kohën tue punue e tue lexue.
Çka kaloni ju tue punue e tue lexue?
Na e kalojmë kohën tue punue e tue lexue.
Cilët e kalojnë kohën tue folë?
Shokët tuej e kalojnë kohën tue folë.

5. A e kaloj unë kohën në kinema?
Po, ju e kaloni kohën në kinema.
Ku e kalon ti kohën?
Unë e kaloj kohën në shtëpí.
Kush e kalon kohën në shtëpí?
Djali im e kalon kohën në shtëpí.
A e kalojmë na kohën në plazhë?
Po, na e kalojmë kohën në plazhë.
Ku e kaloni ju kohën?
Na e kalojmë kohën në plazhë.
Cilët e kalojnë kohën në shkollë?
Nxânsit e kalojnë kohën në shkollë.

6. A i kam lá unë plaçkat?
Po, ju i keni lá plaçkat.
Çka ke lá ti?
Unë i kam lá plaçkat.
Kush i ka lá plaçkat?
Ai i ka lá plaçkat.
A i kemi lá na edhe këmishat?
Po, na i kemi lá edhe këmishat.
Kur i keni lá ju këmishat?
Na i kemi lá këmishat dje.
Cilët nuk i kanë lá këmishat dje?
Ata nuk i kanë lá këmishat dje.

7. A jam lá unë sot në mëngjes me sapun?
Po, ju jeni lá me sapun sot në mëngjes.
Me çka je lá ti sot në mëngjes?
Unë jam lá me sapun sot në mëngjes.
Kush âsht lá me sapun sot në mëngjes?
Ai âsht lá me sapun sot në mëngjes.
A jemi lá na me ujë të nxehët?
Po, na jemi lá me ujë të nxehët.
Me çfarë uji jeni lá ju?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Na jemi lá me ujë të nxehët.
Cilët janë lá me ujë të ftofët?
Ata janë lá me ujë të ftofët.

8. Kur jam në klasë, a qëndroj unë më kambë?
Po, kur jeni në klasë ju qëndroni më kambë.
Po ti, a qëndron më kambë kur je në klasë?
Jo, kur unë jam në klasë nuk qëndroj më kambë.
Kush qëndron më kambë kur âsht në klasë?
Mësuesi qëndron më kambë kur âsht në klasë.
A qëndrojmë na më kambë gjithë ditën?
Jo, na nuk qëndrojmë më kambë gjithë ditën.
Po ju, a qëndroni më kambë gjithë ditën?
Jo, as na nuk qëndrojmë më kambë gjithë ditën.
Cilët nuk qëndrojnë më kambë gjithë ditën?
Ata nuk qëndrojnë më kambë gjithë ditën.

9. A mërzitem unë nganjiherë?
Po, ju mërziteni nganjiherë.
Kur mërzite ti?
Unë mërzitem rrallë.
Kush mërzitet shpesh?
Djali i tij mërzitet shpesh.
A mërzitemi na gjatë pushimevet?
Jo, na nuk mërzitemi gjatë pushimevet.
Kur nuk mërziteni ju?
Na nuk mërzitemi gjatë pushimevet.
Cilët mërziten gjatë pushimevet?
Nuk e dij cilët mërziten gjatë pushimevet.

10. A kujdesohem unë për automobilin tim?
Po, ju kujdesoheni për automobilin tuej.
Për çka kujdesohe ti?
Unë kujdesohem për automobilin tim.
Kush kujdesohet për automobilin e tij?
Xhaja im kujdesohet për automobilin e tij.
A kujdesohemi na për plaçkat tona?
Po, na kujdesohemi për plaçkat tona.
Për çka kujdesoheni ju?
Na kujdesohemi për plaçkat tona.
Cilët kujdesohen për plaçkat e tyne?
Ata kujdesohen për plaçkat e tyne.

11. A mendoni me shkue ndokund nesër?
Jo, nuk mendoj me shkue kund nesër.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ku mendon me shkue ti nesër?
Unë mendoj me shkue nesër në plazhë.
Kur mendon me shkue në qytet baba?
Baba mendon me shkue në qytet sonte.
Ku mendoni me shkue sonte?
Na mendojmë me shkue sonte në bibliotekë.
Po ju, ku mendoni me shkue?
Unë mendoj me shkue me ata tjetërkund.
Ku do të shkojnë ata?
Ata mendojnë me shkue në teatër.

12. Kush shkon për pushime në Florida çdo dy vjetë?
Ai shkon për pushime në Florida çdo dy vjetë.
Ku do të shkoni ju për pushime vjetin që vjen?
Vjetin që vjen unë do të shkoj për pushime në Shqipní.
Në ç'muej shkoj unë për pushime?
Ti shkon për pushime në korrik.
Ku qenë ata për pushime vjet?
Vjet ata qenë për pushime në Francë.
Po ju, ku qetë për pushime vjet?
Vjet unë qesh për pushime n'Afrikë.

13. A âsht i shijshëm mishi i derrit?
Po, mishi i derrit âsht i shijshëm.
Qysh âsht mishi i viçit?
Mishi i viçit âsht i shijshëm.
A âsht e shijshme supa me barishte?
Po, supa me barishte âsht shumë e shijshme.
A janë të shijshme sallatat?
Po, sallatat janë të shijshme.
Cilat gjellë janë të shijshme, zakonisht?
Zakonisht, gjellët që na pëlqejnë janë të shijshme.
A janë të shijshme pemët?
Po, pemët janë të shijshme.
Qysh janë pemët?
Pemët janë të shijshme.

14. A keni leje me hŷ në këtë ndërtesë?
Po, kam leje me hŷ në këtë ndërtesë.
Ku e keni lejën?
E kam në xhep.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A dini me notue?
Po, unë dij me notue.
Kush nuk di me notue?
Motra ime nuk di me notue.

A keni pushim nesër?
Jo, nesër nuk kemi pushim.
Kur keni pushim?
Të shtundevet e të dielevet kemi pushim.
Po të hânevet, a keni pushim?
Jo, të hânevet nuk kemi pushim?

A ju pëlqejnë macat?
Jo, macat nuk më pëlqejnë.
Po qent, a ju pëlqejnë?
Po, qent më pëlqejnë.
A keni qen?
Po, djali im ka nji qen të vogël.

Ku punon vllai juej?
Vllai im punon në nji shoqní.
Në cilën shoqní punon?
Punon në Shoqnín M.T.A.
A âsht e madhe kjo shoqní?
S'âsht as e madhe as e vogël.

A thahen plaçkat në diell?
Po, plaçkat thahen në diell.
Çka thahet në diell?
Plaçkat thahen në diell.
Po lulet, a thahen pa ujë?
Po, lulet thahen pa ujë.
Cilat thahen pa ujë?
Lulet thahen pa ujë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 38
PART V

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

TRANSLATION EXERCISE

1. Kur marr frymë më dhemb gjoksi; a mendoni se jam i ftofun?

2. Malet e nalta janë të mbulueme me borë edhe gjatë verës; atje ajri âsht i pastër dhe, natyrisht, klima âsht e shëndoshët.

3. Ka disa kafshë që hanë gjithë ditën dhe përtypin gati gjithë natën; këto kafshë quhen kafshë përtypëse (ruminants).

4. Për fat të mirë, sot ka ilaçe kaq të mira sa sëmundje që nji herë ishin shumë të rrezikshme, sot konsiderohen (are considered) sëmundje të lehta.

5. Dje erdha në shkollë më kambë sepse kujtova se i kishem humbë çelsat e automobilit; fëmijët i gjetën sot në mëngjes në xhep të xhaketës që kishem ndërrue at ditë.

6. Mbasi i urova nji natë të mirë, aty nga mesnata shkova me fjetë dhe posa mrrîjta në shtëpi piva ca hapa, sepse unë nuk mund të flêj kur bie vonë.

7. Katundarët ditën e pazarit shesin prodhime të ndryshme, si drith, barishte, bylmet etj.

8. Dishroj nji gotë uji dhe nji shishe vene.

9. Kur ishem i vogël, e mbaj në mend si sot, gjyshja më falte çdo të shtunde nji lek; me at lek blejshem sheqerna. Natyrisht që e dojshem shumë gjyshen...

10. Kur ishem i pamartuem miqt më ftojshin shpesh për darkë. Ato darka më kanë kushtue shumë sepse ata kishin shumë fëmijë dhe çdo herë që shkojshem ke ata duhet t'u dërgojshem nga nji peshqesh.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 38

When I was attending high school in Elbasan, one of the two instructors who taught French, and of course who was a Frenchman, used to study Albanian. He thought--and I think he was right--that Albanian is one of the most beautiful languages in Europe, and he knew many of them. He also said that no one spoke it better than the people of Elbasan. In a short time he learned all the grammar and he had a rich vocabulary. In spite of that, he spoke Albanian with a strange (i, e, të çuditshëm) accent (shqiptim, -i), and since he read many old books, he would use a lot of words which were no longer in use. He liked books on the customs of Albania. He would read them with great pleasure. He once read that in the mountains of Albania the women had to wash the guest's feet. This was the only custom he didn't like, but I assured him (me sigurue) that such a custom was not as bad as many others that Europe has.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 38
PART VI
READING TEXT

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

Proverb: Qetsija e mendjes âsht gostí e pandame.

Pogradeci âsht nji qytet i vogël dhe i bukur në breg të liqênit t'Ohrit dhe âsht nji qendër verimi.

Zotní Bakalli me familjen e tij do të nisen për pushime nesër në mëngjes. Edhe sivjet, sikurse vjet, do të shkojnë për nji muej në Pogradec. Klima e Pogradecit âsht e shëndoshët. Liqêni i Ohrit ka nji lloj trofte shumë të shijshme, që quhet koran. Kjo lloj trofte jeton vetëm në këtë liqê.

Zotní Bakalli do të shkojë shpesh me zânë peshk me grep. Në mëngjes heret, ai do të shofi barka me peshkatarë, të cilët shkojnë për të zânë peshk me rrjetë.

Zotní Bakalli do të donte me qëndrue mâ shumë se nji muej në Pogradec, por nuk mundet, mbasi ka vetëm nji muej leje.

Gjatë kohës që ata do të jenë në Pogradec, Zoja Vera, vjehrra e Zotní Bakallit, do të kujdesohet me ujitë kopshtin me lule e, gjithashtu, me u dhânë me hangër qenit e macës së familjes Bakalli.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

LESSON 38

QUESTIONS - PYETJE

1. Çfarë qyteti âsht Pogradeci?
2. Cili qytet âsht nji qendër verimi?
3. Në breg të cilit liqê âsht Pogradeci?
4. Kush do të niset për pushime nesër në mëngjes?
5. Kur do të niset për pushime Zotní Bakalli me familjen e tij?
6. Ku do të shkojnë ata për nji muej?
7. Çka do të bâjnë ata edhe sivjet?
8. Cila klimë âsht e shëndoshët?
9. Qysh âsht klima e Pogradecit?
10. Çfarë lloj trofte ka liqêni i Ohrit?
11. Ku jeton kjo lloj trofte?
12. Qysh âsht korani?
13. Kush do të shkojë shpesh me zânë peshk?
14. Me çka do të zâjë peshk Zotní Bakalli?
15. Çka do të shofi ai në mëngjes heret?
16. Me çka zânë peshk peshkatarët?
17. Kush do të donte me qëndrue mâ shumë se nji muej në Pogradec?
18. Where do I find salt and where do I rinse my mouth?

19. There is salt in the coffee shop, and you go rinse your mouth in the restroom.
20. How much salt shall I put in the water?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

21. Put two or three teaspoons in a glass of water.
22. Are you sure that salt doesn't sting?

23. You weren't afraid to have a tooth pulled out, now you are afraid of salt.
24. All right, all right, I'll go.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

LESSON 42
PART III
GRAMMAR ANALYSIS

PRESENT AND SIMPLE PAST OF THE FOLLOWING VERBS:

me mjelë, me sjellë, me ndie

1. Verbs ending in the infinitive mood in -jelë, -jellë, -edhë, -jerrë are conjugated like the verb me hapë, with the following exceptions:

-je or -e change into -i in the 2nd person plural of the present tense, and into -o in all the persons of the simple past. When this occurs -rr is softened into -r.

Examples:

Infinitive	Present tense 2nd per. plural	Simple past
me mjelë "to milk"	milni	mola, mole moli, etj.
me sjellë "to bring"	sillni	solla, solle, solli, etj.
me vjedhë "to steal"	vidhni	vodha, vodhe, vodhi, etj.
me mbledhë "to gather"	mblidhni	mblodha, mblodhe, etj.
me nxjerrë "to take out"	nxirni	nxora, nxore, etj.

2. Verbs ending in the infinitive mood in -jekë and -jegë are also conjugated like the verb me hapë, with the following exceptions:

-jek changes into -iq and -jeg into -igj in the 2nd person plural of the present tense; in the simple past -jek changes into -oq and -jeg into -ogj.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Examples:

Infinitive	2nd per. plural	Simple past
me ndjekë "to attend"	ndiqni	ndoqa, ndoqe, ndoqi, etj.
me pjekë "to bake"	piqni	poqa, poqe, poqi, etj.
me djegë "to burn"	digjni	dogja, dogje, dogji, etj.

3. Verbs ending in the infinitive mood in -ie are conjugated like the key verb me lâ with the following exception: -ie changes into -je only in the singular of the simple past.

Examples:

Infinitive	Simple past
me ndie "to feel"	Sing.-ndjeva, ndjeve, ndjeu Plural.-ndiem, ndiet, ndien
me përzie "to mix"	Sing.-përzjeva, përzjeve, përzjeu Plural.-përziem, përziet, përzien

THE PREPOSITION DERI AND THE CONJUNCTION DERISA:

Deri and derisa both mean "until." While deri is followed by another preposition (followed by a noun or pronoun) or an adverb, derisa is followed always by a verb.

Examples:

Kam lexue deri në këtë faqe.
(I read until (up to) this page.)

Na duhet të presim deri nesër.
(We have to wait until tomorrow.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Pritni këtu derisa të vîjë nâna.
(Wait here until mother will return.)

Ndejta në shtëpi derisa erdhi nâna.
(I stayed home until mother arrived.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 42
PART IV

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

GRAMMAR DRILL

1. A e hjek unë xhaketën kur shkoj në shtëpí?
Po, ju e hiqni xhaketën kur shkoni në shtëpí.
Çka hjek ti kur shkon në shtëpí?
Unë e hjek xhaketën kur shkoj në shtëpí.
Kush e hjek xhaketën kur shkon në shtëpí?
Ai e hjek xhaketën kur shkon në shtëpí.
A i hjekim na këmishat kur shkojmë në plazhë?
Po, na i hjekim këmishat kur shkojmë në plazhë.
Çka hiqni ju kur shkoni në plazhë?
Na i hjekim këmishat kur shkojmë në plazhë.
Po ata, çka hjekin kur shkojnë në plazhë?
Ata i hjekin rrobet kur shkojnë në plazhë.

2. A i sjell unë librat me vete në shkollë çdo ditë?
Po, ju i silIni librat me vete në shkollë çdo ditë.
Çka sjell ti me vete në shkollë çdo ditë?
Unë sjell librat me vete në shkollë çdo ditë.
Kush i sjell librat me vete në shkollë çdo ditë?
Ai i sjell librat me vete në shkollë çdo ditë.
A i sjellim na cingaret me vete çdo ditë?
Po, na i sjellim cingaret me vete çdo ditë.
Çka sillni ju me vete çdo ditë?
Na i sjellim cingaret me vete çdo ditë.
Çka sjellin ata me vete çdo ditë?
Ata i sjellin cingaret me vete çdo ditë.

A i nxjerr unë shpesh plaçkat nga rafti?
Po, ju i nxirni shpesh plaçkat nga rafti.
Çka nxjerr ti shpesh nga rafti?
Unë i nxjerr shpesh plaçkat nga rafti.
Kush i nxjerr shpesh plaçkat nga rafti?
Ai i nxjerr shpesh plaçkat nga rafti.
A i nxjerrim na çdo ditë librat nga syza?
Po, na i nxjerrim çdo ditë librat nga syza.
Kur i nxirni ju librat nga syza?
Na i nxjerrim çdo ditë librat nga syza.
Çka nxjerrin ata çdo ditë nga syza?
Ata i nxjerrin librat çdo ditë nga syza.

A ndiej unë ndonji dhimbë?
Jo, ju nuk ndieni ndonji dhimbë.
Çka nuk ndien ti?
Unë nuk ndiej ndonji dhimbë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kush nuk ndien ndonji dhimbë?
Ai nuk ndien ndonji dhimbë.
A ndiejmë na ndonji dhimbë?
Jo, na nuk ndiejmë ndonji dhimbë.
Çka nuk ndieni ju?
Na nuk ndiejmë ndonji dhimbë.
Cilët nuk ndiejnë ndonji dhimbë?
Ata nuk ndiejnë ndonji dhimbë.

A i djeg unë gazetat mbasi i lexoj?
Po, ju i digjni gazetat mbasi i lexoni.
Kur i djeg ti gazetat?
Unë i djeg gazetat mbasi i lexoj.
Kush i djeg gazetat mbasi i lexon?
Ai i djeg gazetat mbasi i lexon.
A i djegim na gazetat mbasi i lexojmë?
Po, na i djegim gazetat mbasi i lexojmë.
Kur i digjni ju gazetat?
Na i djegim gazetat mbasi i lexojmë.
Cilët i djegin gazetat mbasi i lexojnë?
Ata i djegin gazetat mbasi i lexojnë.

3. A i hoqa unë pjatat nga tryeza?
Po, ju i hoqët pjatat nga tryeza.
Çka hoqe ti nga tryeza?
Unë i hoqa pjatat nga tryeza.
Kush i hoqi pjatat nga tryeza?
Ai i hoqi pjatat nga tryeza.
A i hoqëm na pjatat e gotat nga tryeza?
Po, na i hoqëm pjatat e gotat nga tryeza.
Çka hoqët ju nga tryeza?
Na i hoqëm pjatat e gotat nga tryeza.
Cilët i hoqën pjatat e gotat nga tryeza?
Ata i hoqën pjatat e gotat nga tryeza.

4. A e solla unë sot çantën me vete?
Po, ju e sollët sot çantën me vete.
Kur e solle ti çantën me vete?
Unë e solla sot çantën me vete.
Kush e solli sot çantën me vete?
Ai e solli sot çantën me vete.
A i sollëm na sot të gjithë librat me vete?
Jo, na nuk i sollëm sot të gjithë librat me vete.
Kur nuk i sollët të gjithë librat me vete?
Sot nuk i sollëm të gjithë librat me vete.
Cilët nuk i sollën sot të gjithë librat me vete?
Ata nuk i sollën sot të gjithë librat me vete.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A i nxora unë të gjitha karrigat nga dhoma?
Po, ju i nxorët të gjitha karrigat nga dhoma.
Çka nxore ti nga dhoma?
Unë i nxora të gjitha karrigat nga dhoma.
Kush i nxori të gjitha karrigat nga dhoma?
Ai i nxori të gjitha karrigat nga dhoma.
A i nxorëm na këpucët nga rafti?
Po, na i nxorëm këpucët nga rafti.
Prej nga i nxorët ju këpucët?
Na i nxorëm këpucët nga rafti.
Cilët i nxorën këpucët nga rafti?
Të gjithë i nxorën këpucët nga rafti.

A ndjeva unë dje nji dhimbë në shpatull?
Po, dje ju ndiet nji dhimbë në shpatull.
Kur ndjeve ti nji dhimbë në shpatull?
Dje unë ndjeva nji dhimbë në shpatull.
Kush ndjeu dje nji dhimbë në shpatull?
Ai ndjeu dje nji dhimbë në shpatull.
A ndiem na dje ndonji dhimbë?
Jo, na dje nuk diem ndonji dhimbë.
Çka nuk ndiet ju dje?
Dje na nuk ndiem ndonji dhimbë.
Cilët nuk ndien dje ndonji dhimbë?
Ata nuk ndien dje ndonji dhimbë.

5. A do të rrini në San Francisco deri të marten?
Po, do të rrij në San Francisco deri të marten?
Deri kur do të rrini në San Francisco?
Do të rrij në San Francisco deri të marten.
Ku do të rrini deri të marten?
Do të rrij në San Francisco deri të marten.
Çka do të bâni në San Francisco deri të marten?
Do të rrij në San Francisco deri të marten.

A do të rrini në klasë derisa të vîjë mësuesi?
Po, do të rrij në klasë derisa të vîjë mësuesi.
Ku do të rrini derisa të vîjë mësuesi?
Do të rrij në klasë derisa të vîjë mësuesi.
Kush do të rrijë në klasë derisa të vîjë mësuesi?
Unë do të rrij në klasë derisa të vîjë mësuesi.
Çka do të bâni derisa të vîjë mësuesi?
Do të rrij në klasë derisa të vîjë mësuesi.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A keni frikë kur jeni në dét vetëm?
Jo, nuk kam frikë kur jam në dét vetëm.
Kush nuk ka frikë kur âsht në dét vetëm?
Ai nuk ka frikë kur âsht në dét vetëm.
Kur nuk ka frikë ai?
Ai nuk ka frikë kur âsht në dét vetëm.

A keni frikë nga qent e mëdhaj?
Jo, unë nuk kam frikë nga qent e mëdhaj.
Kush nuk ka frikë nga qent e mëdhaj?
Ai nuk ka frikë nga qent e mëdhaj.
Nga çka nuk ka frikë ai?
Ai nuk ka frikë nga qent e mëdhaj.
Nga cilët qen nuk ka frikë ai?
Ai nuk ka frikë nga qent e mëdhaj.

A mbaj unë gjithëmonë me vete nji shamí?
Po, ju mbani gjithëmonë me vete nji shamí.
Kush mban gjithëmonë me vete nji shamí?
Ju mbani gjithëmonë me vete nji shamí.
Çka mbaj unë gjithëmonë me vete?
Ju mbani gjithëmonë me vete nji shamí.
Sa shamí mbani ju gjithëmonë me vete?
Unë mbaj gjithëmonë me vete nji shamí.

A ka njeriu 32 dhâmbë?
Po, njeriu ka 32 dhâmbë.
Sa dhâmbë ka njeriu?
Njeriu ka 32 dhâmbë.
Kush ka 32 dhâmbë?
Njeriu ka 32 dhâmbë.
A quhen dhëmballë 20 prej tyne?
Po, 20 prej tyne quhen dhëmballë.
Qysh quhen 20 prej tyne?
20 prej tyne quhen dhëmballë.

A ka shpella ndër male?
Po, ndër male ka shpella.
Ku ka shpella?
Ndër male ka shpella.
Çka ka ndër male?
Ndër male ka shpella.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A prishet koha shpesh në Monterej?
Po, në Monterej prishet koha shpesh.
Kur prishet koha në Monterej?
Në Monterej koha prishet shpesh.
Ku prishet koha shpesh?
Në Monterej koha prishet shpesh.

A i mbushni ju pjatat me gjellë?
Jo, unë nuk i mbush pjatat me gjellë.
Kush i mbush pjatat me gjellë?
Grueja i mbush pjatat me gjellë.
Çka mbush grueja me gjellë?
Grueja i mbush pjatat me gjellë?
Me çka i mbush grueja pjatat?
Grueja i mbush pjatat me gjellë.

6. A do t'i shpërlani rrobet mbasi t'i lani?
Po, mbasi t'i lâj rrobet do t'i shpërlâj.
Kush do t'i shpërlajë rrobet mbasi t'i lajë?
Ai do t'i shpërlajë rrobet mbasi t'i lajë.
Kur do t'i shpërlani rrobet?
Unë do t'i shpërlâj rrobet mbasi t'i lâj.

A ju pëlqen gjella me shumë krypë?
Jo, gjella me shumë krypë nuk më pëlqen.
Kujt nuk i pëlqen gjella me shumë krypë?
Kurrkujt nuk i pëlqen gjella me shumë krypë.
Qysh nuk ju pëlqen gjella?
Nuk më pëlqen gjella me shumë krypë.
A ju pëlqen gjella pa krypë?
Jo, gjella pa krypë nuk më pëlqen.
Kujt nuk i pëlqen gjella pa krypë?
Kurrkujt nuk i pëlqen gjella pa krypë.
Qysh nuk ju pëlqen gjella?
Nuk më pëlqen gjella pa krypë.

A e ndalni automobilin kur mrrîni në shtëpí?
Po, kur mrrîj në shtëpí e ndal automobilin.
Çka ndalni kur mrrîni në shtëpí?
Unë ndal automobilin kur mrrîj në shtëpí.
Kur e ndalni automobilin?
Unë e ndal automobilin kur mrrîj në shtëpí.
Çka bâni kur mrrîni në shtëpí?
Unë e ndal automobilin kur mrrîj në shtëpí.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A ka nevojtore kjo ndërtesë?
Po, kjo ndërtesë ka nevojtore.
Cila ndërtesë ka nevojtore?
Kjo ndërtesë ka nevojtore.
Çka ka kjo ndërtesë?
Kjo ndërtesë ka nevojtore.

A ju dhimti kamba dje?
Po, dje më dhimti kamba.
Kujt i dhimti kamba dje?
Mue më dhimti kamba dje.
Çka ju dhimti jú dje?
Mue më dhimti kamba dje.
Kur ju dhimti kamba?
Mue më dhimti kamba dje.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 42
PART V

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

TRANSLATION EXERCISE

1. Mbas disa ditësh do të shkoj me u-pá me disa miq që kam në disa fshatra në rrethet e Vlonës. Ka vjetë që nuk kam shkue n'ato vende ku kam kalue nji kohë të gjatë kur ishem fëmijë. Rruga nga Vlona deri n'ata fshatra âsht nji rrugë e vjetër dhe âsht prishë krejt nga erënat, ujnat dhe shinat. Automobili shkon deri në gjvmës të rrugës dhe mandej duhet t'udhëtoj më kambë. Nuk besoj të qëndroj atje mâ shumë se nji javë.
2. Jam mërzitë fort nga shëndeti (health) im i keq. Kohët e fundit dhâmbët më kanë dhimtë shpesh, kam pasë të ftofun pa pushim e disa herë grip. Natyrisht, këto sëmundje më kanë mbajtë në shtrat për disa javë. Ilaçet dhe mjeku më kanë kushtue aq shumë që mos e pyet.

---

1. If you really think I am doing nothing good here, I will not stay any longer. What do you think, am I right?
2. Who taught your friend the Albanian language?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

3. The tailor turned to his wife and told her to get out of the shop.
4. Why don't you phone your friend? Don't you believe he has the right to know about this matter?
5. Who picked out these apples? All of them are spoiled.
6. I cannot find the book you lent me. (Use the verb to give.)
7. My father drinks water with his meal.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 42
PART VI
READING TEXT

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

Proverb: Ku dhemb dhâmbi aty shkon gjuha.

Dje në mëngjes më dhimti shumë nji dhëmballë, prandej shkova ke dentisti. Posa hŷna sekretarja më tha me pritë pak mbasi dentisti ishte i zânun. Mbas pak kohe dentisti më ftoi në zyrën e tij. I tregova çka kishem dhe mbasi m'i shikoi dhâmbët, më tha se dhëmballa që më dhimte ishte prishë tepër e s'ishte e mundun me e mbushë, prandej më këshilloi me e nxjerrë.

Mbasi më bâni nji shiringë më nxori dhëmballën. Nuk ndjeva dhimbë. Mbasi filloi me rrjedhë gjak infermierja më dha nji gotë me ujë të krypun për të shpërlá gojën. Më tha t'a vazhdojshem me e bâ këtë gjâ edhe në shtëpí. Uji i krypun âsht shumë i mirë për të ndalë gjakun e për të pastrue gojën.

QUESTIONS - PYETJE

1. Kur më dhimti shumë nji dhëmballë?
2. Çka më dhimti shumë dje në mëngjes?
3. Ku shkova?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

4. Kush më tha me pritë pak mbasi dëntisti ishte i zânun?

5. Çka më tha sekretarja me bâ, posa hŷna?

6. Kush më ftoi në zyrën e tij mbas pak kohe?

7. Ku më ftoi dentisti mbas pak kohe?

8. Kush i tregoi dentistit çka kishem?

9. Kush m'i shikoi dhâmbët?

10. Cila dhëmballë ishte prishë tepër?

11. Çka s'ishte e mundun me bâ?

12. Kê këshilloi dentisti me e nxjerrë?

13. Sa shiringa më bâni dentisti?

14. Çka më nxori mandej?

15. Kush nuk ndjeu dhimbë?

16. Çka filloi me rrjedhë?

17. Kush më dha nji gotë me ujë të krypun?

18. Pse më dha infermierja nji gotë me ujë të krypun?

19. Çka më tha infermierja të vazhdojshem me bâ?

20. Kur do të vazhdojshem me e bâ këtë gjâ?

21. Kush më tha të vazhdojshem me e bâ këtë gjâ edhe mbasi të shkojshem në shtëpí?

22. Për çka âsht shumë i mirë uji i krypun?

23. Çka âsht shumë i mirë për të ndalë gjakun e për të pastrue gojën?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 42
PART VII
HOMEWORK

PJESA E SHTATË
DETYRË SHTËPIJE

Translate into English:

1. Ai dogji gishtin tue ndezë cingaren.
2. Pse nuk e hiqni xhaketën?
3. Kemi ecë gjatë bregut të detit deri afër skeles.
4. Foli me mue derisa erdhi koha me u-nisë.
5. Duhani nuk sjell asnji dobi.

Answer the following questions in Albanian:

1. Cili ka frikë më shumë: qeni nga maca, apo maca nga qeni?
2. Cilave gjâna që hamë nuk u shtijmë krypë?
3. [illegible]u shkoni kur keni dhimbë dhâmbësh?
4. Çka i ngjan automobilit në qoftë se nuk i shtini voj?
5. Në çë rast duhet t'a hiqni kapelën?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 42
PART VIII
VOCABULARY

PJESA E TETË
FJALORI

dentist, -i dentista, -t	(m.)	dentist
derisa	(conj.)	until
me djegë (unë djeg)	(v.)	to burn, sting
dobí, -ja dobí, -t	(f.)	benefit, use, profit, advantage, utility
dhëmballë, -a dhëmballë, -t	(f.)	molar
frikë, -a	(f.)	fear
gisht, -i gishta, -t	(m.)	finger, toe
gjak, -u gjaqe, -t	(m.)	blood, vengeance
me hjekë (unë hjek)	(v.)	to draw, take away, take off, remove; suffer
krypë, -a krypëna, -t	(f.)	salt
i, e, të krypun të krypuna	(adj. m.&f.)	salted
me mbushë (unë mbush)	(v.)	to fill, complete (time)
menjiherë	(adv.)	immediately
mish i dhâmbëvet	(m.)	gum
me ndalë (unë ndal)	(v.)	to stop
me ndezë (unë ndez)	(v.)	to light, to start a fire

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me ndie (unë ndiej)	(v.)	to feel, hear
nevojtore, nevojtorja nevojtore, -t	(f.)	restroom, lavatory
me ngja (ngjaj)	(v.)	to happen, occur; to resemble
me nxjerrë (unë nxjerr)	(v.)	to get out, put out, take out, bring out, draw out
prandej	(conj.)	therefore; so; that's why
me u-prishë (unë prishem)	(v.)	to be broken, destroyed, ruined, erased; be spent (money by waste); be changed (money)
me provue (unë provoj)	(v.)	to prove, try, test
rast, -i raste, -t	(m.)	occasion, chance; case, opportunity
me rrjedhë (unë rrjedh)	(v.)	to flow, run, derive, leak, to come from, originate
shamí, -ja shamí, -t	(f.)	handkerchief
shiringë, -a shiringa, -t	(f.)	injection
shpellë, a shpella, -t	(f.)	cave
me shpërlá (unë shpërláj)	(v.)	to rinse
me shtí (unë shtij)	(v.)	to put in, insert; shoot

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

vɔj, -i vɔjna, -t	(m.)	oil
vrimë, -a vrima, -t	(f.)	hole

NOTES:

...që mos e pyet	...and how! Surely!
besa po	in truth, indeed, well yes
me pasë frikë (unë kam frikë)	to be afraid

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 43
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. (a.)
A shkoni ju shpesh me u-lá në dét?
Po, unë shkoj shpesh me u-lá në dét.

A e lani ju shpesh automobilin?
Po, unë e lâj shpesh automobilin.

A laheni ju shpesh në dét?
Po, unë lahem shpesh në dét.
Kush lahet shpesh në dét?
Unë lahem shpesh në dét. (ti, ai etj.)

A do të laheni nesër në dét?
Po, unë do të lahem nesër në dét.
Kush do të lahet nesër në dét?
Unë do të lahem nesër në dét. (ti, ai etj.)

A e latë automobilin dje?
Po, e lava?
Kush e lau automobilin dje?
Unë e lava automobilin dje. (ti, ai etj.)

A u-latë dje në dét?
Po, unë u-lava dje në dét.
Kush u-lá dje në dét?
Unë u-lava dje në dét. (ti, ai etj.)

A e keni lá ndonjiherë automobilin me sapun?
Po, unë e kam lá shpeshherë automobilin me sapun.
Kush e ka lá automobilin me sapun?
Unë e kam lá automobilin me sapun. (ti, ai etj.)

A jeni lá ndonjiherë në dét?
Po, unë jam lá shpesh në dét.
Kush âsht lá shpesh në dét?
Unë jam lá shpesh në dét. (ti, ai etj.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

(b.)
Kur shkoni në qytet, a duhet me e ndalë shpesh automobilin?
Po, kur shkoj në qytet duhet me e ndalë shpesh automobilin.

A ju pëlqen me u-ndalë shpesh?
Jo, nuk më pëlqen me u-ndalë shpesh.

A e ndalni ju shpesh automobilin në qytet?
Po, unë e ndal shpesh automobilin në qytet.
Kush e ndal shpesh automobilin në qytet?
Unë e ndal shpesh automobilin në qytet. (ti, ai etj.)

A ndaleni ju shpesh në qytet?
Po, unë ndalem shpesh në qytet.
Kush ndalet shpesh në qytet?
Unë ndalem shpesh në qytet. (ti, ai etj.)

A do të ndaleni nesër në qytet?
Po, unë do të ndalem nesër në qytet.
Kush do të ndalet nesër në qytet?
Unë do të ndalem nesër në qytet. (ti, ai etj.)

A e ndalët automobilin dje para shtëpís sime?
Po, dje e ndala automobilin para shtëpís suej.
Kush e ndali automobilin dje para shtëpís sime?
Unë e ndala automobilin dje para shtëpís suej. (ti, ai etj.)

A u-ndalët dje para shtëpís sime?
Po, unë u-ndala para shtëpís suej.
Kush u-ndal para shtëpís sime?
Unë u-ndala para shtëpís suej. (ti, ai etj.)

A e keni ndalë ndonjiherë automobilin para shtëpís sime?
Po, e kam ndalë.
Kush e ka ndalë automobilin para shtëpís sime?
Unë e kam ndalë automobilin para shtëpís suej. (ti, ai etj.)

A jeni ndalë ju para shtëpís sime?
Po, unë jam ndalë para shtëpís suej.
Kush âsht ndalë para shtëpís sime?
Unë jam ndalë para shtëpís suej. (ti, ai etj.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

2. (a.)
A lahem unë mbasi rruhem?
Po, ti lahe mbasi rruhe.
Kush lahet mbasi rruhet?
Ti lahe mbasi rruhe. (ai. na etj.)

(b.)
A vizitohem unë shpesh ke mjeku?
Po, ti vizitohe shpesh ke mjeku.
Kush vizitohet shpesh ke mjeku?
Ti vizitohe shpesh ke mjeku. (ai, na etj.)

(c.)
A takohet ai me mue në kafe?
Po, ai takohet me jú në kafe.
Kush takohet me mue në kafe?
Ai takohet me jú në kafe.

A takohemi na shpesh në kafe?
Po, na takohemi shpesh në kafe.
Cilët takohen shpesh në kafe?
Na takohemi shpesh në kafe. (ju, ata)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 43
PART II
DIALOGUE

PJESA E DYTË
DIALOGU

KE BERBERI

1. Mirë mëngjes! Nga po vjen?
2. Nga berberi. U-rrova e u-qetha.

3. Të dalshin me shëndet! Kur u-qethe kaq heret?
4. Dil nga shtrati, përtac! Ora âsht 9.

5. Pse nuk u-rrove vetë sot?
6. Kur qethem më pëlqen me u-rrue ke berberi.

7. Edhe unë jam bâ për t'u-qethë.
8. Jo vetëm je bâ për t'u-qethë, por edhe për t'u-rrue!

9. Vërtetë, shumë më rriten flokët!
10. Talle? Ke dy muej që nuk qethe.

11. Nuk e shof veten mbrapa kur shikohem në pasqyrë.
12. Shko tash! S'kishte njerí ke berberi.

13. Jo, nuk kam kohë tash; do të qethem të hânen.
14. Do të qethesh të hânen? Të hânevet rrojtorja âsht mbyllë.

15. Atëherë të marten. Tash do të lahem, do të krehem, do të pastrohem e do të dal.
16. Harrove me thânë "do të rruhem."

17. Doemos. Sot kam nji pikëpjekje me rândësí.
18. Me kë ke pikëpjekje?

19. Ajo âsht punë për mue; sa kureshtár je, more burrë!
20. Më fal! Pyeta për gjâna që nuk më përkasin.

21. Mos u-zemro! Desha me u-tallë. S'kam asnji pikëpjekje.
22. Atëherë, a shkojmë në plazhë?

23. Me gjithë qejf! Prit sa të veshem.
24. Shpejtohu se do të takohemi me vajzat; ato po na presin.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ALBANIAN - 43



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 43
PART II
DIALOGUE

PJESA E DYTË
DIALOGU

AT THE BARBER'S

Idiomatic Translation-Përkëthim i Lirë

1. Good morning! Where did you come from?
2. From the barber. I had a shave and haircut.

3. Good for you! How come you had a haircut this early?
4. Get out of bed lazybones! It's 9 o'clock.

5. Why didn't you shave(by)yourself today?
6. When I get a haircut, I like to have a shave by the barber.

7. I need a haircut too.
8. You not only need a haircut but you need a shave as well.

9. Really, my hair grows unusually fast!
10. Are you kidding? You haven't had a haircut for the last two months.

11. I don't see my back (of my head) when I look in the mirror.
12. Go to him now, there's no one there.

13. No, I haven't got time now; I'll go and have a haircut Monday.
14. You'll go and have a haircut Monday? On Monday the barber is closed.

15. Then Tuesday. Now I'll wash, comb myself, clean up and go out.
16. You forgot to say "I'll shave."

17. Of course. Today I have an important appointment.
18. With whom?

19. That's my business. Man, how curious you are.
20. Pardon me! I asked an inappropriate question.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

21. Don't get mad! I was joking. I don't have any appointment.
22. Then, shall we go to the beach?

23. Gladly! Wait awhile until I dress.
24. Make it fast because we have to meet the girls; they are waiting for us.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

PASSIVE VERBS IN ALBANIAN

An active transitive verb (the subject is the doer of the action and it has a complement) can be converted into a passive verb (when the subject is acted upon) by adding u- to the infinitive.

Examples:

Active	Passive
me lá "to wash"	me u-lá "to be washed"
me lexue "to read"	me u-lexue "to be read"
me ndalë "to stop"	me u-ndalë "to be stopped"

Conjugation:

The infinitive form: The passive verbs are formed by placing -u between the particle me and the verb in the active form. Thus the only difference in form between a passive and active verb is the u-.

The present tense: For the great majority of the passive verbs their conjugation follows the following rule:

If the verb in active form ends in the first person present of the indicative mood in -j or a vowel, the passive form in the present tense has the following endings:

	Otherwise:
-hem	-em
-he	-e
-het	-et
-hemi	-emi
-heni	-eni
-hen	-en

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Examples:

	Pres. 1st pers.		Pres. tense
me çue	çoj	me u-çue	ço-hem ço-he ço-het ço-hemi ço-heni ço-hen
me këthye	këthej	me u-këthye	këthe-hem këthe-he këthe-het këthe-hemi këthe-heni këthe-hen
me vû	vê	me u-vû	vê-hem vê-he vê-het vê-hemi vê-heni vê-hen
me kapë	kap	me u-kapë	kap-em kap-e kap-et kap-emi kap-eni kap-en
me nisë	nis	me u-nisë	nis-em nis-e nis-et nis-emi nis-eni nis-en

As far as endings are concerned, the above rule has no exceptions, but quite a few passive verbs have some changes in the stem, before taking the ending.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Examples:

Pres. 1st pers.			Pres. tense
me pritë	pres	me u-pritë	pritem
me djegë	djeg	me u-djegë	digjem

(We shall deal with these verbs later on.)

The future tense: With the exception of the second person singular which takes an extra -sh in the future and of course do të, present and future are alike in form.

Examples:

	Present	Future
me u-çue	çohem	do të çohem
	çohe	do të çohesh
	çohet	do të çohet
	çohemi	do të çohemi
	çoheni	do të çoheni
	çohen	do të çohen
me u-nisë	nisem	do të nisem
	nise	do të nisesh
	niset	do të niset
	nisemi	do të nisemi
	niseni	do të niseni
	nisen	do të nisen

The simple past tense: Active verbs and passive verbs have the same conjugation with the following difference:

Passive verbs are preceded by u-. The 3rd person of the singular is different (usually has the same form as the infinitive with short vowel).

Examples:

Past active			Past passive
me lá	lava	me u-lá	u-lava
	lave		u-lave

(continued)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

	Past active		Past passive
	lau		u-lá
	lamë		u-lamë
	latë		u-latë
	lanë		u-lanë
me hapë	hapa	me u-hapë	u-hapa
	hape		u-hape
	hapi		u-hap
	hapem		u-hapem
	hapët		u-hapët
	hapën		u-hapën

The compound tense: While the active verbs are conjugated with the auxiliary me pasë, the passive verbs are conjugated with the auxiliary me genë.

Examples:

me lá	kam lá, etj.	me u-lá	jam lá, etj.
	kishem lá, etj.		ishem lá, etj.
	do të kem lá, etj.		do t'ishem lá, etj.

USAGE OF PASSIVE VERBS

It is very important to remember the following facts concerning the usage of the passive verbs.

The action of the verb may be reflected on the subject; in other words the subject and the object refer to the same person. This kind of verb is called reflexive and it is translated in English with reflexive pronouns or with intransitive verbs.

Examples:

Djalit nuk i pëlqen me u-lá me ujë të ftofët.
(The boy doesn't like to wash himself with cold water.)

Ai u-zgjue heret.
(He woke up early.) (lit. meaning: woke up himself)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Unë u-rrova sot dý herë.
(I shaved twice today.) (lit. meaning: I shaved myself)

The subject is acted upon; in other words, an action completed by somebody else refers to the subject. This "somebody else" may be mentioned in the sentence but usually it is understood in the context.

Examples:

Qyteti u-bombardue dý herë (nga aviacioni, nga artilerija, etj).
(The city was bombed twice (by planes, artillery, etc.).

U-bâ nji luftë e rreptë (nga kjo ase ajo ushtrí).
(A rough war was fought (by this or that army).

Mësuesi ynë quhet Agim (nga të gjithë).
(Our teacher is called Agim (by everybody).

Such passive verbs may be converted into active transitive; in this, of course, the complement agent which is acting on the subject will become subject. The above sentences will become the following:

(Aviacioni, artilerija, etj.) e bombardoi qytetin dý herë.
(The planes, the artillery, etc.) bombarded the city twice.

(Kjo ase ajo ushtrí) bâni nji luftë të rreptë.
(This or that army) fought a rough war.

Mësuesin e quejnë Agim.
(They call the teacher Agim.)

The action of the verb may be performed by 2 or more persons who act reciprocally on each other and each of them, at the same time, is acted upon the other.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Examples:

Nânë e bir u-përqafuen = Nâna e përqafoi djalin dhe ai e përqafoi nânën.
(Mother and son embraced)(each other).

Agimi e Tefta u-martuen dje.
(Agim and Tefta got married yesterday). = One married the other and vice versa.

As you see, we have two subjects in the above sentences; it is possible to split them in one subject and one direct complement preceded by the preposition me; the action of reciprocity will not be affected.

Examples:

Nâna u-përqafue me djalin.

Agimi u-martue me Teftën.

Important annotation: Some verbs in Albanian may be passive in form but are not used as strictly intransitive verbs, in such a case they will have none of the above characteristics of the passive verbs.

Examples:

Unë u-përgjegja mirë.
(I answered well.)

Djali kollet gjithë natën.
(The boy coughs all night.)

Duket se âsht i pasun.
(He seems to be rich.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 43
PART IV
GRAMMAR DRILL

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

1. A shikohem unë në pasqyrë kur krehem?
Po, ju shikoheni në pasqyrë kur kreheni.
Ku shikohe ti kur krehe?
Unë shikohem në pasqyrë kur krehem.
Kush shikohet në pasqyrë kur krehet.
Ai shikohet në pasqyrë kur krehet.
A shikohemi na në pasqyrë kur krehemi?
Jo, na nuk shikohemi në pasqyrë kur krehemi.
Po ju, a shikoheni në pasqyrë kur kreheni?
Jo, as na nuk shikohemi në pasqyrë kur krehemi.
Cilët nuk shikohen në pasqyrë kur krehen?
Ata nuk shikohen në pasqyrë kur krehen.

A u-zemrova unë kur humba të hollat?
Po, ju u-zemruet kur humbët të hollat.
Kur u-zemrove ti?
Unë u-zemrova kur humba të hollat.
Kush u-zemrue kur humbi të hollat?
Ai u-zemrue kur humbi të hollat
A u-zemruem na kur erdhi djali vonë në shtëpi?
Po, na u zemruem kur erdhi djali vonë në shtëpi.
Kur u-zemruet ju?
Na u-zemruem kur erdhi djali vonë në shtëpi.
Cilët u-zemruem kur erdhi djali vonë në shtëpi?
Ata u-zemruen kur erdhi djali vonë në shtëpi.

A do të çohem unë vonë këtë fund jave?
Po, ju do të çoheni vonë këtë fund jave.
Kur do të çohesh ti vonë?
Unë do të çohem vonë këtë fund jave.
Kush do të çohet vonë këtë fund jave?
Ai do të çohet vonë këtë fund jave.
A do të çohemi na nesër në mëngjes n'orën gjashtë?
Po, na do të çohemi nesër në mëngjes n'orën gjashtë.
Në ç'orë do të çoheni ju nesër?
Na do të çohemi nesër n'orën gjashtë.
Cilët do të çohen nesër n'orën gjashtë?
Ata do të çohen nesër n'orën gjashtë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

2. A rruhem unë çdo ditë?
Po, ju rruheni çdo ditë.
A rruhe ti çdo mëngjes para se me u-lá?
Po, unë rruhem çdo mëngjes para se me u-lá.
Kush rruhet çdo mëngjes para se me u-lá?
Ai rruhet çdo mëngjes para se me u-lá.
A rruhemi na me ujë të nxehët?
Po, na rruhemi me ujë të nxehët.
Me çfarë uji rruheni ju?
Na rruhemi me ujë të nxehët.
Cilët rruhen çdo mëngjes me ujë të nxehët?
Ata rruhen çdo mëngjes me ujë të nxehët.

A u-rrova unë dje mbasi u-lava?
Po, ju u rruet dje mbasi u-latë.
Kur u-rrove ti dje?
Unë u-rrova dje mbasi u-lava.
Kush u-rrue dje mbasi u-lá?
Ai u-rrue dje mbasi u-lá.
A u-rruem na dje posa u-lamë?
Po, na u-rruem dje posa u-lamë.
Kur u-rruet ju dje?
Na u-rruem dje posa u-lamë.
Cilët u-rruen dje posa u-lanë?
Ata u-rruen dje posa u-lanë.

A do të rruhem unë nesër ke berberi?
Po, ju do të rruheni nesër ke berberi.
Ku do të rruhesh ti nesër?
Unë do të rruhem nesër ke berberi.
Kush do të rruhet nesër ke berberi?
Ai do të rruhet nesër ke berberi.
A do të rruhemi na nesër mbasi të hamë?
Po, na do të rruhemi nesër mbasi të hamë.
Kur do të rruheni ju nesër?
Na do të rruhemi nesër mbasi të hamë.
Cilët do të rruhen nesër mbasi të hanë?
Ata do të rruhen nesër mbasi të hanë.

3. A qethem unë, zakonisht, nji herë në muej?
Po, ju qetheni, zakonisht, nji herë në muej.
Kur qethe ti zakonisht?
Unë qethem, zakonisht, nji herë në muej.
Kush qethet shumë shpesh?
Ai qethet shumë shpesh.
A qethemi na, zakonisht, të shtundevet?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Po, na qethemi, zakonisht, të shtundevet.
Ç'ditë qetheni ju, zakonisht?
Na qethemi, zakonisht, të shtundevet.
Cilët qethen, zakonisht, të merkurrevet?
Ata qethen zakonisht të merkurrevet.

A u-nisa unë vjet me aeroplan për Florida?
Po, ju u-nisët vjet me aeroplan për Florida.
Me çka u-nise ti vjet për Florida?
Unë u-nisa vjet për Florida me aeroplan.
Kush u-nis vjet për Florida me aeroplan?
Ai u-nis vjet për Florida me aeroplan.
A u-nisëm na për pushime me automobil?
Po, na u-nisëm për pushime me automobil.
Me çka u-nisët ju për pushime?
Na u-nisëm për pushime me automobil.
Cilët u-nisën për pushime me tren?
Shokët u-nisën për pushime me tren.

A do të veshem unë nesër me rrobe tjera?
Po, ju do të vesheni nesër me rrobe tjera.
Me çfarë rrobesh do të vesheni ju nesër?
Unë do të veshem nesër me rrobe tjera.
Kush do të veshet nesër me rrobe tjera?
Ai do të veshet nesër me rrobe tjera.
A do të veshemi na të dielen me kostum kombëtar?
Po, na do të veshemi të dielen me kostum kombëtar.
Me çfarë kostumi do të vesheni ju të dielen?
Na do të veshemi të dielen me kostum kombëtar.
Cilët do të veshen të dielen me kostum kombëtar?
Ata do të veshen të dielen me kostum kombëtar.

4. A krehem unë çdo mëngjes?
Po, ju krehëni çdo mëngjes.
Kush krehet çdo mëngjes?
Ti krehe çdo mëngjes.
Me çka krehemi na çdo mëngjes?
Ju krehëni me krahën çdo mëngjes.
Çka bâjnë ata çdo mëngjes?
Ata krehen me krahën çdo mëngjes.

A lahen mirë plaçkat pa sapun?
Jo, plaçkat nuk lahen mirë pa sapun.
Qysh lahen plaçkat pa sapun?
Plaçkat nuk lahen mirë pa sapun.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Çka nuk lahet mirë pa sapun?
Plaçkat nuk lahen mirë pa sapun.
Pa çka nuk lahen mirë plaçkat?
Plaçkat nuk lahen mirë pa sapun.

A takohe ti me shokët nji herë në javë?
Po, unë takohem me shokët nji herë në javë.
Kush takohet me shokët nji herë në javë?
Unë takohem me shokët nji herë në javë.
Me kë takohemi na nji herë në javë?
Na takohemi me shokët nji herë në javë.
Kur takoheni ju me shokët?
Na takohemi me shokët nji herë në muej.
Sa herë në muej takohen ata me shokët?
Ata takohen me shokët dy herë në muej.

5. A rruhem vetë unë çdo ditë?
Po, ju rruheni vetë çdo ditë.
Kur rruhe vetë ti?
Unë rruhem vetë çdo ditë.
Kush rruhet vetë gjithëmonë?
Ai rruhet vetë gjithëmonë.
A rruhemi vetë na gjithëmonë?
Jo, na nuk rruhemi vetë gjithëmonë.
A rruheni vetë ju gjithëmonë?
Jo, as na nuk rruhemi vetë gjithëmonë.
Cilët nuk rruhen vetë gjithëmonë?
Shokët e mij nuk rruhen vetë gjithëmonë.

A shkon ti vetë me blé harxhin?
Po, unë vetë shkoj me blé harxhin.
Kush shkon me blé harxhin?
Na vetë shkojmë me blé harxhin.
A shkoni ju vetë me blé harxhin?
Jo, na vetë nuk shkojmë me blé harxhin.
Cilët nuk shkojnë vetë me blé harxhin.
Ata nuk shkojnë vetë me blé harxhin.

A e ndigjoj unë veten kur flas?
Po, ju e ndigjoni veten kur flitni.
A e ndigjon ti veten kur flet?
Po, unë e ndigjoj veten kur flas.
Kush e ndigjon veten kur flet?
Ai e ndigjon veten kur flet.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A e ndigjojmë na veten kur flasim?
Po, na e ndigjojmë veten kur flasim.
A e ndigjoni ju veten kur flitni?
Po, na e ndigjojmë veten kur flasim.
Cilët nuk e ndigjojnë veten kur flasin?
Ata që nuk ndiejnë nuk e ndigjojnë veten kur flasin.

A i merr ti librat me vete çdo ditë?
Po, unë i marr librat me vete çdo ditë.
Kush i merr librat me vete çdo ditë?
Na i marrim librat me vete çdo ditë.
Ku i merrni ju librat çdo ditë?
Na i marrim librat me vete çdo ditë.
Cilët nuk i marrin librat me vete çdo ditë?
Ata nuk i marrin librat me vete çdo ditë.

6. A âsht përtac njeriu që rri në shtrat deri vonë?
Po, njeriu që rri në shtrat deri vonë âsht përtac.
Kush âsht përtac?
Njeriu që rri në shtrat deri vonë âsht përtac.
Çka âsht njeriu që rri në shtrat deri vonë?
Njeriu që rri në shtrat deri vonë âsht përtac.

A rriten lulet mâ shpejt se pemët?
Po, lulet rriten mâ shpejt se pemët.
Çka rriten mâ shpejt se pemët?
Lulet rriten mâ shpejt se pemët.
Qysh rriten lulet?
Lulet rriten mâ shpejt se pemët.

A âsht automobili i tij mbrapa ndërtesës sonë?
Po, automobili i tij âsht mbrapa ndërtesës sonë.
Automobili i kujt âsht mbrapa ndërtesës sonë?
Automobili i tij âsht mbrapa ndërtesës sonë.
Mbrapa cilës ndërtesë âsht automobili i tij?
Automobili i tij âsht mbrapa ndërtesës sonë.
Ku âsht automobili i tij?
Automobili i tij âsht mbrapa ndërtesës sonë.

A jeni mbrapa me mësime?
Jo, unë nuk jam mbrapa me mësime.
Kush nuk âsht mbrapa me mësime?
Ai nuk âsht mbrapa me mësime?
Qysh âsht ai me mësime?
Ai nuk âsht mbrapa me mësime.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A âsht mbyllë zyra e postës të dielevet?
Po, zyra e postës âsht mbyllë të dielevet.
Cila zyrë âsht mbyllë të dielevet?
Zyra e postës âsht mbyllë të dielevet.
Ç'ditë âsht mbyllë zyra e postës?
Zyra e postës âsht mbyllë të dielevet.
Kur âsht mbyllë zyra e postës?
Zyra e postës âsht mbyllë të dielevet.

A kam unë pikëpjekje me doktorin sot n'orën 5?
Po, sot n'orën pesë ju keni pikëpjekje me doktorin.
Kush ka pikëpjekje me doktorin sot n'orën 5?
Ju keni pikëpjekje me doktorin sot n'orën pesë.
Me kë kam pikëpjekje sot n'orën 3?
Sot n'orën tre keni pikëpjekje me nji vajzë.
Çka kam sot n'orën 3?
Sot n'orën 3 keni pikëpjekje me nji vajzë.
Kur kam pikëpjekje me nji vajzë?
Sot n'orën 3 keni pikëpjekje me nji vajzë.
Në ç'orë keni pikëpjekje me nji vajzë?
Sot n'orën 3 kam pikëpjekje me nji vajzë.

A âsht mirë me futë hundët në punët që nuk
të përkasin?
Jo, nuk âsht mirë me futë hundët në punët që
nuk të përkasin.
Çka nuk âsht mirë me bâ?
Nuk âsht mirë me futë hundët në punët që nuk
të përkasin.
Ku nuk âsht mirë me futë hundët?
Nuk âsht mirë me futë hundët në punët që nuk
të përkasin.
Në cilat punë nuk âsht mirë me futë hundët?
Nuk âsht mirë me futë hundët në punët që nuk
të përkasin.

A âsht kureshtár djali i Zotní Gjikës?
Po, djali i Zotní Gjikës âsht mjaft kureshtár.
Djali i kujt âsht mjaft kureshtár?
Djali i Zotní Gjikës âsht mjaft kureshtár.
Ç'ka âsht djali i Zotní Gjikës?
Djali i Zotní Gjikës âsht mjaft kureshtár.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

LESSON 43
PART V
TRANSLATION EXERCISE

Shqipnija ndahet në 27 rrethe. Trí nga rrethet e Shqipnís janë edhe këto: rrethi i Pogradecit, i Korçës dhe i Ersekës. Në këto rrethe ka male të nalta, si p. sh. Mali i Thatë, Morava, Gramosi, Ostrovica, Malet e Mokrës etj. Në mes (in the middle) të këtyne maleve gjinden dý fusha shumë pjellore: Fusha e Kolonjës 1000 m. nalt dhe Fusha e Korçës 800 m. nalt. Dy lumej rrjedhin në këto rrethe: Devolli dhe Osumi ase Lumi i Beratit. Qyteti mâ me rândësí i rrethit të Pogradecit âsht Pogradeci, që gjindet në breg të Liqenit t'Ohrit, gjymsa e të cilit i përket Shqipnís. Ky qytet ka natyrë e pamje të bukura si edhe klimë të shëndetëshme. Korça, në lindje të fushës së Korçës, âsht qyteti mâ i madh i Shqipnís së Jugut. Ky qytet âsht qendër bujqësije e tregtije, ka mjaft fabrika, mâ të rândësishmet e të cilave janë: fabrika e sheqerit dhe ajo e birrës. Qyteti i tretë, që mund të quhet mâ shumë nji fshat i madh se sa nji qytet i vogël âsht Bilishti. Qendra tjera me rândësí që u përkasin këtyne trí rretheve janë: Vithkuqi, Dardha, Voskopoja, Erseka e Leskoviku.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

1. What's the matter with you? Why are you pale? Are you cold?
2. There is a gentleman at the door who would like to speak to you. Could I let him in? He is a friend of yours, I think.
3. It's a quarter past ten, and the train leaves at five minutes to eleven. Hurry up or you'll miss it! (me humbë)
4. It was foggy but it didn't rain when we left Tirana for Durrës. At Ndroq, however, the wind was blowing very hard, and it was just beginning to snow.
5. The students, themselves, want to wake up early.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 43
PART VI
READING TEXT

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

Proverb: Kur s'ke punë luej derën.

Sot në mëngjes, posa u-çova, u-lava e u-vesha dhe shkova me hangër mëngjes. Menjiherë, posa mbarova, shkova ke berberi me u-qethë e me u-rrue. Nuk prita shumë në rrojtore mbasi aty punojnë katër berberë. Posa u-lirue karriga e parë u-ula dhe i thash berberit me më qethë e me më rrue. Zakonisht, kur shkoj më u-qethë më pëlqen edhe me u-rrue ke berberi. Kur mbaroi punë u-çova, pagova dhe dola.

Kur u-këtheva në dhomë Bashkimi ishte ende në shtrat. Ai flên deri vonë kur nuk kemi shkollë. Më pyeti pse ishem çue aq heret, mbasi sot âsht e shtunde. I tregova se qesh ke berberi e atëherë më tha se edhe ai ishte bâ për t'u-qethë. I thash të shkonte ke berberi se nuk ishte shumë i zânun, por ai tha se do të shkonte të marten. Bashkimit nuk i pëlqen shumë me shkue ke berberi, prandej nuk qethet shpesh; qethet nji herë në 5-6 javë.

QUESTIONS - PYETJE

1. Çka bâna sot në mëngjes posa u-çova?
2. Kur u-lava u-vesha dhe shkova me hangër mëngjes?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

3. Ku shkova menjiherë, posa mbarova me hangër mëngjes?
4. Kur shkova ke berberi me u-qethë e me u-rrue?
5. Ku nuk prita shumë?
6. Sa berberë punojnë në rrojtoren ku shkova unë?
7. Çka bâna posa u-lirue karriga e parë?
8. Kujt i thash me më qethë e me më rrue?
9. Kujt i pëlqen me u-rrue ke berberi kur shkon me u-qethë?
10. Çka bâna unë kur mbaroi punë berberi?
11. Kur u-çova, pagova dhe dola?
12. Ku ishte Bashkimi kur u-këtheva në dhomë?
13. Kush ishte ende në shtrat kur u-këtheva në dhomë?
14. Çka bân ai kur nuk kemi shkollë?
15. Deri kur flên ai kur nuk kemi shkollë?
16. Kush më pyeti pse ishem çue aq heret?
17. Pse më pyeti Bashkimi pse ishem çue aq heret?
18. Kush i tregoi se kishte qenë ke berberi?
19. Kush më tha se ishte bâ për t'u-qethë?
20. Çka i thash unë?
21. Pse i thash të shkonte ke berberi?
22. Kush nuk ishte shumë i zânun?
23. Kur tha ai se do të shkonte?
24. Kujt nuk i pëlqen shumë me shkue ke berberi?
25. Kush qethet nji herë në 5-6 javë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 43
PART VII
HOMEWORK

PJESA E SHTATË
DETYRË SHTËPIJE

Answer the following questions:

1. Sa herë në muej qetheni?
2. Me kê u-takuet dje?
3. Kur u-vizituet herën e fundit te mjeku?
4. Me çka krehen flokët?
5. Sa herë në ditë duhet të lahen dhâmbët?

Substitute the underlined verb with the verb in parenthesis and rebuild the sentence. For further clarity look at the pattern.

Sentence to be rebuilt:

Fëmijët <u>lahen</u> prej nânës (me lâ).

Rebuilt sentence:

Nâna i lan fëmijët.

1. Dhoma <u>pastrohet</u> prej nxânësvet. (me pastrue)
2. Unë <u>u-vizitova</u> prej mjekut mâ të mirë.(me vizitue)
3. Ai <u>quhet</u> Agim. (me quejtë)
4. Na e <u>takojmë</u> shpesh njâni tjetrin. (me u-takue)
5. Prej kujt <u>u-lexue</u> mësimi? (me lexue)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TETË
FJALORI

LESSON 43
PART VIII
VOCABULARY

doemos	(adv.)	by all means, of course, as a matter of course
me u-krehë (unë krehem)	(v.)	to comb oneself
kureshtár, -i kureshtarë, -t	(m.)	curious
kureshtár, -e kureshtarë	(adj. m.&f.)	curious
me u-lirue (unë lirohem)	(v.)	to be liberated, freed, relieved; reduced in price
mbrapa	(adv. & prep.)	behind, back, in the rear, backwards; slow (for timepieces)
me u-mbyllë (unë mbyllem)	(v.)	to be closed, to be shut in
me u-pastrue (unë pastrohem)	(v.)	to be cleaned, to clean up
me përkitë (unë përkas)	(v.)	to touch; belong, concern, relate to, pertain
më, të, i, etj. përket (përkasin)	(v.)	it is my, your, etc. business, I am expected to
nuk më, të, i, etj. përket (përkasin)	(v.)	it is no business of mine, yours, etc., I am not expected to
përtac, -i përtacë, -t	(m.)	lazybones, a lazy person

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

përtac, -e përtacë	(adj. m.&f.)	lazy
pikëpjekje, pikëpjekja pikëpjekje, -t	(f.)	appointment, date, rendezvous
me u-qethë (unë qethem)	(v.)	to have a haircut, shear, tonsure
me u-rritë (unë rritem)	(v.)	to grow, grow up, raise, to be raised
rrojtore, rrojtorja rrojtore, -t	(f.)	barbershop
me u-shikue (unë shikohem)	(v.)	to watch, look (oneself)
me u-shpejtue (unë shpejtohem)	(v.)	to hurry
me u-takue (unë takohem)	(v.)	to meet
me u-tallë (unë tallem)	(v.)	to kid, hoax, jeer, scoff at, banter, tease, joke, jest, mock
me u-veshë (unë veshem)	(v.)	to get dressed
vete, vetja	(f.)	self (an emphasized form of the pron. meaning one's true, normal self. Ex: I shall defend myself.)
vetë (unë vetë, ti vetë, etj.)	(adj.& pron.)	myself, yourself, etc. I personally, you personally,etc.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me u-zemrue (unë zemrohem)	(v.)	to get angry, be angry

NOTES:

të dalshin me shëndet!	(A greeting when addressing someone who just had his hair cut.)
me gjithë qejf	with pleasure, gladly I'd like to
... more burrë!	... my dear! ...man!
âsht punë për mue (për, ty, atê, etj.)	it is my (your, his, etc.) business
me u-bâ për t'u-rrue (bâhem për t'u-rrue)	to need a shave
me u-bâ per t'u-qethë (bâhem për t'u-qethë)	to need a haircut
s'ka (s'kishte, s'do të ketë, etj) njerí	there isn't (wasn't, won't be, etc.) anybody

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E PARË PART I

USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. A çohem unë heret kur shkoj në shkollë?
Po, ju çoheni heret kur shkoni në shkollë.
Kur çohe ti heret?
Unë çohem heret kur shkoj në shkollë.
Kush çohet heret kur shkon në shkollë?
Ai çohet heret kur shkon në shkollë.
A çohemi na vonë kur nuk shkojmë në shkollë?
Po, na çohemi vonë kur nuk shkojmë në shkollë.
Kur çoheni ju?
Na çohemi vonë.
Cilët çohen vonë?
Ata çohen vonë.

A çoheshem unë heret kur shkojshem në shkollë?
Po, ju çoheshi heret kur shkojshi në shkollë.
Kur çoheshe ti kur shkojshe në shkollë?
Unë çoheshem heret kur shkojshem në shkollë.
Kush çohesh heret kur shkonte në shkollë?
Ai çohesh heret kur shkonte në shkollë.
A çoheshim na heret kur shkojshim në shkollë?
Po, na çoheshim heret kur shkojshim në shkollë.
Cilët çoheshin heret kur shkojshin në shkollë?
Ata çoheshin heret kur shkojshin në shkollë.

2. A qethem unë, zakonisht, nji herë në muej?
Po, ju qetheni, zakonisht, nji herë në muej.
Kur qethe ti, zakonisht?
Unë qethem, zakonisht, nji herë në muej.
Kush qethet, zakonisht, nji herë në muej?
Ai qethet, zakonisht, nji herë në muej.
A qethemi na, zakonisht, nji herë në muej?
Po, na qethemi, zakonisht, nji herë në muej.
Kur qetheni ju, zakonisht?
Na qethemi, zakonisht, nji herë në muej.
Cilët qethen, zakonisht, nji herë në muej?
Ata qethen, zakonisht, nji herë në muej.

A qetheshem unë çdo dý javë kur ishem n'ushtrí?
Po, ju qetheshi çdo dý javë kur ishi n'ushtrí.
Kur qetheshe ti kur ishe n'ushtrí?
Unë qetheshem çdo dý javë kur ishem n'ushtrí.
Kush qethesh çdo dý javë kur ishte n'ushtrí?
Ai qethesh çdo dý javë kur ishte n'ushtrí.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A qetheshim na çdo dý javë kur ishim ushtarë?
Po, na qetheshim çdo dý javë kur ishim ushtarë.
Kur qetheshi ju kur ishi ushtarë?
Na qetheshim çdo dý javë kur ishim ushtarë.
Cilët qetheshin çdo dý javë kur ishin ushtarë?
Ata qetheshin çdo dý javë kur ishin ushtarë.

3. A rruhem unë çdo mëngjes para se të vîj në shkollë?
Po, ju rruheni çdo mëngjes para se të vîni në shkollë.
A rruhe ti çdo mëngjes para se të vîjsh në shkollë?
Po, unë rruhem çdo mëngjes para se të vîj në shkollë.
Kush rruhet çdo mëngjes para se të vîjë në shkollë?
Ai rruhet çdo mëngjes para se të vîjë në shkollë.
A rruhemi na çdo mëngjes para se të vîjmë në shkollë?
Po, na rruhemi çdo mëngjes para se të vîjmë në shkollë.
A rruheni ju çdo mëngjes para se të vîni në shkollë?
Po, na rruhemi çdo mëngjes para se të vîjmë në shkollë.
Cilët rruhen çdo mëngjes para se të vîjnë në shkollë?
Ata rruhen çdo mëngjes para se të vîjnë në shkollë.

A rruheshem unë mâ rrallë kur ishem i rí?
Po, ju rruheshi mâ rrallë kur ishi i rí.
Kur rruheshe ti kur ishe i rí?
Unë rruheshem mâ rrallë kur ishem i rí.
Kush rruhesh mâ rrallë kur ishte i rí?
Ai rruhesh mâ rrallë kur ishte i rí.
A rruheshim na mâ rrallë kur ishim të rij?
Po, na rruheshim mâ rrallë kur ishim të rij.
Sa herë rruheshi ju kur ishi të rij?
Na rruheshim mâ rrallë kur ishim të rij.
Cilët rruheshin mâ rrallë kur ishin të rij?
Ata rruheshin mâ rrallë kur ishin të rij.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

4. A ruhem unë nga automobilat kur jam në qytet?
Po, ju ruheni nga automobilat kur jeni në qytet.
Kur ruhe ti nga automobilat?
Unë ruhem nga automobilat kur jam në qytet.
Kush ruhet nga automobilat kur âsht në qytet?
Ai ruhet nga automobilat kur âsht në qytet.
A ruhemi na nga automobilat kur jemi në qytet?
Po, na ruhemi nga automobilat kur jemi në qytet.
Nga çka ruheni ju kur jeni në qytet?
Na ruhemi nga automobilat kur jemi në qytet.
Cilët ruhen nga automobilat kur janë në qytet?
Ata ruhen nga automobilat kur janë në qytet.

A ruheshem unë nga të ftoftit kur ishem fëmijë?
Po, ju ruheshi nga të ftoftit kur ishi fëmijë.
Kur ruheshe ti nga të ftoftit?
Unë ruheshem nga të ftoftit kur ishem fëmijë.
Kush ruhesh nga të ftoftit kur ishte fëmijë?
Ai ruhesh nga të ftoftit kur ishte fëmijë.
A ruheshim nga të ftoftit na kur ishim fëmijë?
Po, na ruheshim nga të ftoftit kur ishim fëmijë.
Kur ruheshi ju nga të ftoftit?
Na ruheshim nga të ftoftit kur ishim fëmijë.
Cilët ruheshin nga të ftoftit kur ishin fëmijë?
Ata ruheshin nga të ftoftit kur ishin fëmijë.

5. A bâhem unë merak kur nuk kam të holla?
Po, ju bâheni merak kur nuk keni të holla.
Kur bâhe ti merak?
Unë bâhem merak kur nuk kam të holla.
Kush bâhet merak kur nuk ka të holla?
Ai bâhet merak kur nuk ka të holla.
A bâhemi na merak kur nuk kemi të holla?
Po, na bâhemi merak kur nuk kemi të holla.
Kur bâheni merak ju?
Na bâhemi merak kur nuk kemi të holla.
Cilët bâhen merak kur nuk kanë të holla?
Ata bâhen merak kur nuk kanë të holla.

A bâheshem unë merak kur ishem i sëmundë?
Po, ju bâheshi merak kur ishi i sëmundë.
A bâheshe ti merak kur ishe i sëmundë?
Po, unë bâheshem merak kur ishem i sëmundë.
Kush bâhesh merak kur ishte i sëmundë?
Ai bâhesh merak kur ishte i sëmundë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A bâheshim na merak kur ishim të sëmundë?
Po, na bâheshim merak kur ishim të sëmundë.
Kur bâheshi ju merak?
Na bâheshim merak kur ishim të sëmundë.
Cilët bâheshin merak kur ishin të sëmundë?
Ata bâheshin merak kur ishin të sëmundë.

6. A këthehem unë shtëpí kur dal nga shkolla?
Po, ju këtheheni në shtëpí kur dilni nga shkolla.
Kur këthehe ti në shtëpí?
Unë këthehem në shtëpí kur dal nga shkolla.
Kush këthehet në shtëpí kur del nga shkolla?
Ai këthehet në shtëpí kur del nga shkolla.
A këthehemi na në shtëpí kur dalim nga shkolla?
Po, na këthehemi në shtëpí kur dalim nga shkolla.
Kur këtheheni ju në shtëpí?
Na këthehemi në shtëpí kur dalim nga shkolla.
Cilët këthehen në shtëpí kur dalin nga shkolla?
Ata këthehen në shtëpí kur dalin nga shkolla.

A këtheheshem unë në shkollë mbas pushimevet verore?
Po, ju këtheheshi në shkollë mbas pushimevet verore.
Kur këtheheshe ti në shkollë?
Unë këtheheshem në shkollë mbas pushimevet verore.
Kush këthehesh në shkollë mbas pushimevet verore?
Ai këthehesh në shkollë mbas pushimevet verore.
A këtheheshim na në shkollë mbas pushimevet verore?
Po, na këtheheshim në shkollë mbas pushimevet verore.
Cilët këtheheshin në shkollë mbas pushimevet verore?
Ata këtheheshin në shkollë mbas pushimevet verore.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 44
PART II
DIALOGUE

BOMBARDIMET AJRORE

1. Ku keni qenë gjatë Luftës së Dytë Botënore?
2. Në Shqipní; aty nga fundi i luftës kam shkue n'Italí e në Francë.

3. A janë bombardue rândë nga aeroplanat qytetet e Shqipnís?
4. Durrsi âsht bombardue ca herë; ato t'Italís e të Gjermanís janë bombardue vazhdimisht.

5. Ju vetë, a keni pësue ndonji nga këto bombardime?
6. Kam pësue së paku njizet bombardime.

7. Në ç'kohë bombardoheshin qytetet?
8. Zakonisht natën, por nganjiherë edhe ditën.

9. Si mbroheshin njerzit nga bombardimet?
10. Shumëkush largohesh nga qyteti dhe këthehesh të nesërmen në mëngjes.

11. Po tjerët, çka bâjshin?
12. Dikush strehohesh në bodrum e dikush rrinte në shtëpí... në dorë të Zotit.

13. Ku shkojshin ata që largoheshin?
14. Pazari mbyllesh heret dhe njerzija niseshin për në katundet përreth.

15. Ku flejshin gjithë këta njerëz?
16. Përdhé. Futeshin njizet vetë në nji dhomë: grât veç e burrat veç.

17. A i bâjshi edhe ju çdo natë këto udhëtime?
18. Po, sa herë që ishte e mundun me hypë në tramvaj ase n'autobus.

19. Në ç'kohë niseshi?
20. Unë niseshem aty nga mbrâmja.

21. A bâheshin vjedhje e grabitje në këto qytete gjymës bosh?
22. Shumë rrallë ndigjohesh se janë bâ krime të tilla.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

DIALOGUE

Idiomatic Translation-Përkëthim i Lirë

1. Where were you during World War II?
2. In Albania; towards the end of the war I went to Italy and France.

3. Were the cities of Albania heavily bombed by airplanes?
4. Durrës was bombed many times. The cities of Italy and Germany were bombed continuously.

5. Were you personally in any of these bombings?
6. Yes, I was in at least twenty bombings.

7. At what time would the cities be bombed?
8. Usually at night, but some times during daytime.

9. How would people protect themselves from bombs?
10. Many would leave the cities in the evening and come back the next morning.

11. What about the others, what would they do?
12. Some would find shelter in the basements and others would stay in their apartments ..... in God's hands.

13. Where would those who left in the evening go?
14. The stores closed early and people would leave for the nearby villages.

15. Where did all these people sleep?
16. On the floor. Twenty people would stay in one room, men on one side and women on the other side.

17. Did you make these trips every night?
18. Yes, whenever it was possible to get on a streetcar or on a bus.

19. At what time did you leave?
20. I used to leave at dusk.

21. Did stealing and robbing occur in these half empty cities?
22. One seldom heard that such crimes were committed.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 44
PART III

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

GRAMMAR ANALYSIS

THE IMPERFECT OF THE INDICATIVE MOOD OF THE PASSIVE VERB

In the imperfect, indicative mood, the stem of the active and passive verbs remains the same. Changes occur internally except for the third person singular, where changes occur internally and finally.

The stem for both active and passive conjugations in the imperfect of the indicative mood is zgjo-; the internal change occurs from active j to passive he ; whereas in the third person singular from active (n)te to passive hesh.

Examples:

	Active verbs		Passive verbs
me zgjue	zgjojshem	me u-zgjue	zgjoheshem
	zgjojshe		zgjoheshe
	zgjonte		zgjohesh
	zgjojshim		zgjoheshim
	zgjojshi		zgjoheshi
	zgjojshin		zgjoheshin
me këthye	këthejshem	me u-këthye	këtheheshem
	këthejshe		këtheheshe
	këthente		këthehesh
	këthejshim		këtheheshim
	këthejshi		këtheheshi
	këthejshin		këtheheshin

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me hapë	hapshem	me u-hapë	hapeshem
	hapshe		hapeshe
	hapte		hapesh
	hapshim		hapeshim
	hapshi		hapeshi
	hapshin		hapeshin
me futë	futshem	me u-futë	futeshem
	futshe		futeshe
	futte		futesh
	futshim		futeshim
	futshi		futeshi
	futshin		futeshin

Remark: The passive verbs have two conjugations in the imperfect. The above is one of them which we will call Conjugation A. We will deal in the next lesson with Conjugation B.

THE INDEFINITE PRONOUNS

Declension: The indefinite pronouns-- ndokush, dikush, shumëkush, pakkush, gjithëkush, askush, kurrkush (kërkush), etc. are declined like kush.

Usage: Ndokush "somebody, anybody" is usually used in interrogative sentences and sometimes in negative sentences.

Examples:

A âsht ndokush atje?
(Is anybody there?)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Examples: (Continued)

Jo, nuk âsht ndokush. or Jo, nuk âsht askush.
(No, there isn't anybody.) (No, nobody is there.)

A njifni ndokênd?
(Do you know anybody.)

Jo, nuk njof ndokênd. or Jo, nuk njof askênd.
(No, I don't know anybody.) (No, I know nobody.)

Usage: Dikush "somebody, someone" is used in positive sentences when we don't know the person or we don't want to mention the person whom this pronoun is replacing.

Examples:

Dikush duhet të ketë qenë këtu.
(Somebody must have been here.)

Dikush âsht tue trokitë në derë.
(Someone is knocking on the door.)

Thuhet se kur ju kruhet dora e majtë do të merrni të holla prej ndokujt.
(It is said that when your left hand itches, you will receive money from someone.)

Dikush që qe për darkë mbrâmë te unë më tha se kishte qenë në Shqipnî dy muej mâ parë.
(Somebody who was for dinner at my place last night, told me that he has been in Albania two months ago.)

Sonte kam pikëpjekje me dikê.
(I have a date tonight with somebody.)

Çka jeni tue bâ?
(What are you doing?)

Jam tue i shkruar dikujt.
(I am writing to somebody.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

VERBS me u-largue versus me u-nisë

The English-speaking students should be careful when they are using these two verbs, which both may be translated with the verb to leave.

U-largue means get away, go away, dissociate, be separated, and sometimes to leave but not in the sense of an act of departure. The verb me u-nisë has the latter meaning. The following examples will clarify it, but if in doubt one should remember:

The antonym of the verb me u-largue is me u-afrue "to approach, get close" while the antonym of me u-nisë is me mrrîjtë "to arrive."

Examples:

U-largova nga shkolla për arsyena shëndetsore.
(I left school because of my health.)

Do të nisem nesër n'orën 5.
(I'll leave tomorrow at 5 o'clock.)

Largohuni nga ata dy shokë; ata nuk janë aspak njerëz të mirë.
(Get away from those two friends of yours; they are not good men.)

Vetëm mbasi u-largova nga ai qytet plot lagështinë filloi me u-përmirësue shëndeti im.
(My health started to improve only after I left that city which was so humid.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 44
PART IV

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

GRAMMAR DRILL

1. A zgjoheshem unë vonë kur nuk kishem shkollë?
Po, ju zgjoheshi vonë kur nuk kishi shkollë.
Kur zgjoheshe ti kur nuk kishe shkollë?
Unë zgjoheshem vonë kur nuk kishem shkollë.
Kush zgjohesh vonë kur nuk kishte shkollë?
Ai zgjohesh vonë kur nuk kishte shkollë.
A zgjoheshim na vonë gjatë pushimevet?
Po, na zgjoheshim vonë gjatë pushimevet.
Kur zgjoheshi ju gjatë pushimevet?
Na zgjoheshim vonë gjatë pushimevet.
Cilët zgjoheshin vonë gjatë pushimevet?
Ata zgjoheshin vonë gjatë pushimevet.

A jam zgjue sot n'orën gjashtë e gjymës?
Po, sot ju jeni zgjue n'orën gjashtë e gjymës.
Kur je zgjue ti sot?
Unë jam zgjue sot n'orën gjashtë e gjymës.
Kush âsht zgjue sot n'orën gjashtë e gjymës?
Ai âsht zgjue sot n'orën gjashtë e gjymës.
A jemi zgjue na sot n'orën gjashtë e gjymës?
Po, na jemi zgjue sot n'orën gjashtë e gjymës.
Në ç'orë jeni zgjue ju sot?
Sot na jemi zgjue n'orën gjashtë e gjymës.
Cilët janë zgjue sot n'orën gjashtë e gjymës?
Ata janë zgjue sot n'orën gjashtë e gjymës.

2. A niseshem heret për në shkollë kur banojshem jashtë qytetit?
Po, ju niseshi heret për në shkollë kur banojshi jashtë qytetit.
Kur niseshe ti për në shkollë kur banojshe në shtëpín tjetër?
Unë niseshem heret për në shkollë kur banojshem në shtëpín tjetër.
Kush nisesh heret për në shkollë kur banonte në shtëpín tjetër?
Ai nisesh heret për në shkollë kur banonte në shtëpín tjetër.
A niseshim na heret për në shkollë kur banojshim në shtëpín tjetër?
Po, na niseshim heret për në shkollë kur banojshim në shtëpín tjetër.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kur niseshi ju për në shkollë kur banojshi në shtëpín tjetër?
Na niseshim heret për në shkollë kur banojshim në shtëpín tjetër.
Cilët niseshin heret për në shkollë kur banojshin në shtëpín tjetër?
Ata niseshin heret për në shkollë kur banojshin në shtëpín tjetër.

A jam nisë unë heret dje për të shkue në Korçë?
Po, ju jeni nisë heret për të shkue në Korçë.
Në ç'orë jeni nisë ju?
Unë jam nisë n'orën 8.
Në ç'orë je nisë ti për të ardhë këtu?
Unë jam nisë 10 minuta mbas Zotnî Beratit.
A jemi nisë na më vonë se zakonisht?
Po, na jemi nisë dje më vonë se zakonisht.
Pse jeni nisë dje aq vonë?
Na jemi nisë vonë sepse jemi zgjue vonë.
Cilët janë nisë më heret?
Ata janë nisë më heret.

3. A rruheshem unë të dielevet kur jetojshem në fshat?
Jo, ju nuk rruheshi të dielevet kur jetojshi në fshat.
Kur nuk rruheshe ti?
Unë nuk rruheshem të dielevet kur jetojshem në fshat.
Kush nuk rruhesh të dielevet kur jetonte në fshat?
Ai nuk rruhesh të dielevet kur jetonte në fshat.
A rruheshim na të dielevet kur jetojshim në fshat?
Po, na rruheshim të dielevet kur jetojshim në fshat.
A rruheshi ju të dielevet kur jetojshi në fshat?
Po, edhe na rruheshim të dielevet kur jetojshim në fshat.
Cilët rruheshin të dielevet kur jetojshin në fshat?
Ata rruheshin të dielevet kur jetojshin në fshat.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A jam rrue unë sot mbas orës shtatë?
Po, sot ju jeni rrue mbas orës shtatë.
Në ç'orë je rrue ti sot?
Unë jam rrue sot mbas orës shtatë.
Kush âsht rrue sot mbas orës shtatë?
Ai âsht rrue sot mbas orës shtatë.
A jemi rrue na sot mbasi hangrëm mëngjes?
Po, sot na jemi rrue mbasi hangrëm mëngjes.
Kur jeni rrue ju sot?
Sot na jemi rrue mbasi hangrën mëngjes.
Cilët janë rrue sot mbasi hangrën mëngjes?
Ata janë rrue sot mbasi hangrën mëngjes.

4. A ruheshem unë shumë mbasi dola nga spitali?
Po, ju ruheshi shumë mbasi dolët nga spitali.
Kur ruheshe ti shumë?
Unë ruheshem shumë mbasi dola nga spitali.
Kush ruhesh shumë mbasi doli nga spitali?
Ai ruhesh shumë mbasi doli nga spitali.
A ruheshim na shumë mbasi dolëm nga spitali?
Po, na ruheshim shumë mbasi dolëm nga spitali.
Kur ruheshi ju shumë?
Na ruheshim shumë mbasi dolëm nga spitali.
Cilët ruheshin shumë mbasi dolën nga spitali?
Ata ruheshin shumë mbasi dolën nga spitali.

A jam ruejtë mos me bâ gabime gjatë provimit?
Po, ju jeni ruejtë mos me bâ gabime gjatë provimit.
Kur je ruejtë ti mos me bâ gabime?
Unë jam ruejtë mos me bâ gabime gjatë provimit.
Kush âsht ruejtë mos me bâ gabime gjatë provimit?
Ai âsht ruejtë mos me bâ gabime gjatë provimit.
A jemi ruejtë na mos me bâ gabime gjatë provimit?
Po, na jemi ruejtë mos me bâ gabime gjatë provimit.
Kur jemi ruejtë na mos me bâ gabime?
Na jemi ruejtë mos me bâ gabime gjatë provimit.
Cilët janë ruejtë mos me bâ gabime gjatë provimit?
Ata janë ruejtë mos me bâ gabime gjatë provimit.

5. A bâheshem unë merak kur ishem i sëmundë?
Po, ju bâheshi merak kur ishi i sëmundë.
Kur bâheshe merak ti?
Unë bâheshem merak kur ishem i sëmundë.
Kush bâhesh merak kur ishte i sëmundë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ai bâhesh merak kur ishte i sëmundë.
A bâheshim na merak kur ishim të sëmundë?
Po, na bâheshim merak kur ishim të sëmundë.
Kur bâheshi merak ju?
Na bâheshim merak kur ishim të sëmundë.
Cilët bâheshin merak kur ishin të sëmundë?
Ata bâheshin merak kur ishin të sëmundë.

A jam bâ merak unë sepse nuk më ka shkrue djali tash dy muej?
Po, ju jeni bâ merak sepse nuk ju ka shkrue djali tash dy muej.
Pse je bâ merak ti?
Unë jam bâ merak sepse nuk më ka shkrue djali tash dy muej.
Kush âsht bâ merak sepse nuk i ka shkrue djali tash dy muej?
Ai âsht bâ merak sepse nuk i ka shkrue djali tash dy muej.
A jemi bâ merak na sepse nuk na ka shkrue djali tash dy muej?
Po, na jemi bâ merak sepse nuk na ka shkrue djali tash dy muej.
Pse jeni bâ merak ju?
Na jemi bâ merak sepse djali nuk na ka shkrue tash dy muej.
Cilët janë bâ merak sepse nuk u ka shkrue djali tash dy muej?
Ata janë bâ merak sepse djali nuk u ka shkrue tash dy muej.

6. A këtheheshem unë drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkojshem në shkollë?
Po, ju këtheheshi drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkojshi në shkollë.
Kur këthehesbe ti drejt në shtëpí?
Unë këtheheshem drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkojshem në shkollë.
Kush këthehesh drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkonte në shkollë?
Ai këthehesh drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkonte në shkollë.
A këtheheshim na drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkojshim në shkollë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Po, na këtheheshim drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkojshim në shkollë.
Kur këtheheshi ju drejt në shtëpí?
Na këtheheshim drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkojshim në shkollë.
Cilët këtheheshin drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkojshin në shkollë?
Ata këtheheshin drejt në shtëpí në mbrâmje kur shkojshin në shkollë.

A jam këthye dje mbasdreke nga leja?
Po, ju jeni këthye dje mbasdreke nga leja.
Kur jeni këthye nga leja?
Dje mbasdreke jam këthye nga leja.
Kush âsht këthye dje mbasdreke nga leja?
Ai âsht këthye dje mbasdreke nga leja.
A jemi këthye nga kinemaja n'orën nândë?
Po, na jemi këthye nga kinemaja n'orën nândë.
Në ç'orë jeni këthye ju nga kinemaja?
Na jemi këthye nga kinemaja n'orën nândë.
Cilët janë këthye nga kinemaja n'orën nândë?
Ata janë këthye nga kinemaja n'orën nândë.

7. A mbaroi Lufta e Dytë Botënore në vjetin 1945?
Po, Lufta e Dytë Botënore mbaroi në vjetin 1945.
Cila luftë mbaroi në vjetin 1945?
Lufta e Dytë Botënore mbaroi në vjetin 1945.
Në ç'vjet mbaroi Lufta e Dytë Botënore?
Lufta e Dytë Botënore mbaroi në vjetin 1945.
Kur mbaroi Lufta e Dytë Botënore?
Lufta e Dytë Botënore mbaroi në vjetin 1945.
Po Lufta e Parë Botënore, në ç'vjet mbaroi?
Lufta e Parë Botënore mbaroi në vjetin 1918.
Cila luftë mbaroi në vjetin 1918?
Lufta e Parë Botënore mbaroi në vjetin 1918.
Në ç'vjet mbaroi Lufta e Parë Botënore?
Lufta e Parë Botënore mbaroi në vjetin 1918.

A flêjnë njerzit zakonisht natën apo ditën?
Njerzit flêjnë zakonisht natën.
Kur flêjnë njerzit zakonisht?
Njerzit flêjnë zakonisht natën.
Kush flên natën zakonisht?
Njerzit flêjnë zakonisht natën.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A keni udhëtue ndonjiherë me aeroplan natën?
Po, unë kam udhëtue me aeroplan natën.
Kush ka udhëtue me aeroplan natën?
Unë kam udhëtue me aeroplan natën.
Me çka keni udhëtue ju natën?
Unë kam udhëtue me aeroplan natën.
Çka kam bâ me aeroplan natën?
Ju keni udhëtue me aeroplan natën.
Kur keni udhëtue me aeroplan?
Unë kam udhëtue me aeroplan natën.

A shkon ndokush me tren në Durrës?
Po, shumëkush shkon me tren në Durrës.
Kush shkon me tren në Durrës?
Shumëkush shkon me tren në Durrës.
Me çka shkon shumëkush në Durrës?
Shumëkush shkon me tren në Durrës.
Ku shkon shumëkush me tren?
Shumëkush shkon me tren në Durrës.

A punon ndokush edhe të dielevet?
Po, dikush punon edhe të dielevet.
Kush punon edhe të dielevet?
Dikush punon edhe të dielevet.
Çka bân dikush edhe të dielevet?
Dikush punon edhe të dielevet.
Ç'ditë punon dikush?
Dikush punon edhe të dielevet.

8. A kanë bodrum të gjitha shtëpít?
Jo, të gjitha shtëpít nuk kan bodrum.
Çka s'kanë të gjitha shtëpít?
Të gjitha shtëpít nuk kanë bodrum.
A ka bodrum shtëpija juej?
Jo, shtëpija ime nuk ka bodrum.
Cila shtëpí nuk ka bodrum?
Shtëpija ime nuk ka bodrum.
Shtëpija e kujt nuk ka bodrum?
Shtëpija ime nuk ka bodrum.

A shkon njerzija në plazhë në verë?
Po, njerzija shkon në plazhë në verë.
Çka bân njerzija në verë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Njerzija shkon në plazhë në verë.
Ku shkon njerzija në verë?
Njerzija shkon në plazhë në verë.

A rrijnë burrat veç e grât veç në kishë n'Evropë?
Po, në disa vende t'Evropës burrat rrijnë veç e grât veç në kishë.
Në cilat vende rrijnë burrat veç e grât veç në kishë?
Në disa vende t'Evropës burrat rrijnë veç e grât veç në kishë.
A rrijnë nxânsit veç e nxânset veç në klasë këtu n'Amerikë?
Jo, këtu n'Amerikë nxânsit e nxânset nuk rrijnë veç e veç në klasë; rrijnë bashkë.
Në cilin vend nuk rrijnë nxânsit veç e nxânset veç në klasë?
N'Amerikë nxânsit e nxânset nuk rrijnë veç e veç në klasë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 44
PART V

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

TRANSLATION EXERCISE

Rrethi i Beratit

Dý malet mâ të nalta të rrethit të Beratit janë Tomori dhe Shpiragu. Ky rreth ka edhe shumë kodra. Fushat e këtij rrethi gjinden në të dý anët e lumit Osum. Popullsija e rrethit të Beratit merret me bujqësí; prodhimet kryesore janë; gruni, misri, orizi (rice), pambuku si edhe zarzavatet e pemët. Pothuej të gjitha kodrat e këtij rrethi janë të mbulueme me ullîj, që janë sa të mirë për t'u-hangër ashtu edhe për industrín e vojit (oil). Atje rriten shumë edhe kafshët shtëpijake (që quhen edhe "kafshë të trasha"), si lopët e kuajt, dhe shpendët shtëpijakë, si patat, pulat e gjelat e detit. Rândësín mâ të madhe rrethi i Beratit e ka n'industrín e vojgurit (petroleum); këtu gjindet Qyteti Stalin (para luftës quhesh Kuçovë) me afërsisht 10.000 banorë dhe që âsht qendra mâ e madhe e prodhimit të vojgurit.

Qyteti mâ i madh âsht Berati (15.000 banorë), i ndërtuem në të dý anët e Osumit, aty ku del në fushë. Të dyja këto pjesë të qytetit janë të bashkueme nga nji urë shumë e vjetër. Qyteti âsht

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

i ndërtuem në dy kodra përreth lumit (river) dhe ka

nji pamje të mrekullueshme.

---

1. Tell those boys to enter the classroom.

2. Please go on reading, I wish to hear the end of the story.

3. If you really intend going to Tiranë on a Monday, you had better leave there about 6 o'clock in the evening; it gets too hot during the day.

4. Would she prefer going with her sister or staying at home?

5. They quit working (use me u-largue) and the next day they left by bus.

6. A workman now gets about 800 leks a week, while a few years ago he did not get more than 300. On the other hand, the cost of living (jeta) today is ten times more expensive than a few years ago.

7. Tell me please, where is your barbershop? I need a haircut and I want to get shaved.

8. It is getting late, we must not stop any longer.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 44
PART VI
READING TEXT

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

Proverb: Zoti më ruejttë nga miku se nga anmiku ruhem vetë.

Gjatë Luftës së Dytë Botënore edhe Shqipnija, si shumë vende tjera t'Europës, ka pësue bombardime ajrore. Durrsi u-bombardue mâ shumë se çdo qytet tjetër i Shqipnís; skelja e tij u-shkatrrue krejt gjatë luftës, por mâ vonë u-rindërtue.

Qytetet zakonisht bombardoheshin natën, por nganjiherë edhe ditën. Për t'u-mbrojtë nga bombardimet shumë nga banorët largoheshin nga qyteti në mbrâmje dhe këtheheshin të nesërmen në mëngjes. Të tjerët qëndrojshin në shtëpít e tyne dhe po të kishte ndonji bombardim gjatë natës strehoheshin në bodrum. Mbasdreke pazari mbyllesh heret dhe banorët niseshin për në katundet përreth qytetit. Nuk ishte shumë e lehtë me gjetë mjete udhëtimi, mbasi të gjithë largoheshin pothuej në të njâjtën kohë. Të gjithë hypshin ndër automobila, autobusa e karroca për të shkue me kalue natën në fshat. Ata që rrijshin në qytet shkojshin heret në shtëpí mbasi, si thamë mâ nalt, të gjitha dyqanet, kafet, kinemat etj. mbylleshin porsa vînte mbrâmja e rrugët ishin bosh.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Gjatë natës nuk shifesh asnji dritë (light), as ndër shtëpít e as në rrugët e qytetit.

Me gjithë këtê shumë rrallë ndigjohesh se ishte bâ ndonji krim si p. sh. vjedhje ase grabitje.

QUESTIONS - PYETJE

1. Cili shtet ka pësue bombardime ajrore gjatë luftës?
2. Kur ka pësue Shqipnija bombardime ajrore?
3. Cili qytet u-bombardue mâ shumë se çdo qytet tjetër i Shqipnís?
4. Skelja e cilit qytet u-shkatrrue krejt gjatë luftës?
5. Kur u-rindërtue Durrsi?
6. Kur bombardoheshin zakonisht qytetet?
7. Cilët largoheshin nga qyteti për t'u-mbrojtë nga bombardimet?
8. Çka bâjshin shumë nga banorët në mbrâmje për t'u-mbrojtë nga bombardimet?
9. Kur këtheheshin në qytet?
10. Cilët këtheheshin të nesërmen në mëngjes?
11. Çka bâjshin të tjerët?
12. Cilët qëndrojshin në shtëpít e tyne?
13. Ku strehoheshin po të kishte ndonji bombardim gjatë natës?
14. Kur strehoheshin në bodrum?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

15. Çka mbyllesh mbasdreke heret?

16. Kur mbyllesh pazari?

17. Cilët niseshin për në katundet përreth qytetit?

18. Çka nuk ishte shumë e lehtë me gjetë?

19. Cilët largoheshin pothuej në të njâjtën kohë?

20. Pse nuk ishte shumë e lehtë me gjetë mjete udhëtimi?

21. Ku hypshin të gjithë?

22. Ku shkojshin me kalue natën ata që largoheshin nga qyteti?

23. Çka mbyllesh?

24. Qysh ishin rrugët?

25. Ku nuk shifesh gjatë natës asnji dritë?

26. Sa nerë ndigjohesh se ishte bâ ndonji vjedhje ase grabitje?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 44
PART VII
HOMEWORK

PJESA E SHTATË
DETYRË SHTËPIJE

Përgjegjuni këtyne pyetjeve:

1. Në ç'orë zgjoheshi kur ishi në shkollë të mesme?

2. A do të largoheni nga Monterey kur t'a mbaroni kursin?

3. Pse futen kafshët nëpër shpella kur moti âsht shumë i keq? (to shelter)

4. Kur flêjnë njerzit, zakonisht, dhe kur punojnë?

5. Për se na shërben bodrumi?

Përkëtheni shqip këto fjalí:

6. I got on the chair, so that I could reach the book on top of the cupboard.

7. There were no chairs, so I sat on the floor.

8. Did anybody go to the PX to buy cigarettes?
Yes, somebody went there but I don't know who.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TETË
FJALORI

LESSON 44
PART VIII
VOCABULARY

ajruer, ajrore ajrorë	(adj. m.&f.)	of the air, air-
bodrum, -i bodrume, -t	(m.)	cellar, basement
bombardim,-i bombardime, -t	(m.)	bombardment
bombardim ajruer	(m.)	air raid
me u-bombardue (unë bombardohem)	(v.)	to be bombed, bombarded, strafed
botënuer, botënore botënorë	(adj. m.&f.)	world-, world-wide, universal
dikush	(pron.)	somebody
ditën	(adv.)	in the day time, during the day
fund, -i funde, -t	(m.)	end, bottom
me u-futë (unë futem)	(v.)	to get inside, enter, to be inserted
grabitje, grabitja grabitje, -t	(f.)	robbery, kidnaping
me hypë (unë hyp)	(v.)	go up, rise, get on, climb, mount, board a
krim, -i krime, -t	(m.)	crime
me u-largue (unë largohem)	(v.)	get away, go away from, be gone, be severed, dissociated, leave

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

luftë, -a lufta, -t	(f.)	war
me u-mbrojtë (unë mbrohem)	(v.)	to defend oneself; to protect oneself
megjithëkëtê	(conj.)	nevertheless, however
natë, -a netë, -t	(f.)	night
natën	(adv.)	at night, in the night, by night, during the night
me u-ndigjue (unë ndigjohem)	(v.)	to be heard, listened, obeyed
të nesërmen	(adv.)	the next day
nëpër	(prep.)	through, in
njerzí, -ja	(f.)	people; politeness
së paku	(adv.)	at least
me pësue (unë pësoj)	(v.)	to suffer, endure
rândë	(adv.)	severely, seriously, heavy, heavily
me u-rindërtue (rindërtohet)	(v.)	to be reconstructed, rebuilt, renovated
me u-strehue (unë strehohem)	(v.)	to be sheltered, harbored
shumëkush	(pron.)	many a person, many people, many

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

tramvaj, -i tramvaje, -t	(m.)	streetcar
udhëtim, -i udhëtime, -t	(m.)	trip, travel, journey
vazhdimisht	(adv.)	continuously
veç ase veç e veç	(adv.)	apart, separately
vjedhje, vjedhja vjedhje, -t	(f.)	theft
Zot, -i zota, -t	(m.)	God, deities

NOTES:

aty nga	thereabout, around

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 45
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. A zgjoheshi ju heret kur shkojshi në punë?
Po, unë zgjoheshem heret kur shkojshem në punë.
A u-zgjojshi ju heret kur shkojshi në punë?
Po, unë u-zgjojshem heret kur shkojshem në punë.
Kush u-zgjonte heret kur shkonte në punë?
Ti u-zgjojshe heret kur shkojshe në punë.
A u-zgjonte edhe ai heret kur shkonte në punë?
Po, edhe ai u-zgjonte heret kur shkonte në punë.
A u-zgjojshi ju heret kur ishi n'ushtrí?
Po, na u-zgjojshim heret kur ishim n'ushtrí.
A u-zgjojshim na heret kur ishim n'ushtrí?
Po, ju u-zgjojshi heret kur ishi n'ushtrí.
Cilët u-zgjojshin heret kur ishin n'ushtrí?
Ata u-zgjojshin heret kur ishin n'ushtrí.

A niseshi ju heret kur shkojshi në katund?
Po, unë niseshem heret kur shkojshem në katund.
A u-nisshi ju heret kur shkojshi në katund?
Jo, unë u-nisshem vonë kur shkojshem në katund.
Kush u-niste vonë kur shkonte në katund?
Ti u-nisshe vonë kur shkojshe në katund.
Po ai. a -niste heret a vonë kur shkonte në katund?
Ai u-niste heret kur shkonte në katund.
A u-nisshi ju n'orën 7 në mëngjes kur shkojshi në Tiranë?
Po, na u-nisshim n'orën 7 në mëngjes kur shkojshim në Tiranë.
A u-nisshim na n'orën 7 në mëngjes kur shkojshim në Tiranë?
Po, ju u-nisshi n'orën 7 në mëngjes kur shkojshi në Tiranë.
A u-nisshin ata para nesh kur shkojshin në punë?
Po, ata u-nisshin para nesh kur shkojshin në punë.

A këtheheshi më kambë a me autobus nga puna në shtëpí?
Unë këtheheshem nga puna në shtëpí më kambë.
A u-këthejshi më kambë a me autobus nga puna në shtëpí?
Unë u-këthejshem nga puna në shtëpí më kambë.
Kush u-këthente më kambë nga puna në shtëpí?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ti u-këthejshe më kambë nga puna në shtëpí.
Po ai, a u-këthente më kambë nga puna në shtëpí?
Po, edhe ai u-këthente më kambë nga puna në shtëpí.
A u-këthejshi ju në shtëpí në kohë të darkës?
Po, na u-këthejshim në shtëpí në kohë të darkës.
A u-këthejshim na në shtëpí në kohë të darkës?
Po, ju u-këthejshi në shtëpí në kohë të darkës.
Në ç'kohë u-këthejshin ata në shtëpí?
Ata u-këthejshin në shtëpí në kohë të darkës.

4. A qetheshi ju nji herë në dý javë apo më shpesh?
Unë qetheshem nji herë në dý javë.
A u-qethshi ju nji herë në dý javë apo më shpesh?
Unë u-qethshem nji herë në dý javë.
Kush u-qethte nji herë në dý javë?
Ju u-qethshi nji herë në dý javë.
Po ai, a u-qethte nji herë në dý javë?
Po, edhe ai u-qethte nji herë në dý javë.

A u-qethshi ju ke berberi italian?
Po, na u-qethshim ke berberi italian.
Cilët u-qethshin ke berberi italian?
Ju u-qethshi ke berberi italian.
A u-qethshin edhe ata ke berberi italian?
Po, edhe ata u-qethshin ke berberi italian.

5. A merrni ju libra nga biblioteka popullore?
Po, unë marr libra nga biblioteka popullore.
A marr unë libra nga biblioteka popullore?
Po, ju merrni libra nga biblioteka popullore.
Kush merr libra nga biblioteka popullore?
Ai merr libra nga biblioteka popullore.
A merrni ju letra nga Shqipnija?
Po, na marrim letra nga Shqipnija.
A marrim na paqeta nga prindët?
Po, ju merrni paqeta nga prindët.

6. A u epni ju fëmijëvet qumësht?
Po, unë u ap fëmijëvet qumësht.
Kush u ep fëmijëvet qumësht?
Ju u epni fëmijëvet qumësht.
A u ep ai fëmijëvet qumësht?
Po, ai u ep fëmijëvet qumësht.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A u epni ju fëmijëvet peshqeshe për Krishtlindje?
Po, na u apim fëmijëvet peshqeshe për Krishtlindje.
A u apim na fëmijëvet peshqeshe për Krishtlindje?
Po, ju u epni fëmijëvet peshqeshe për Krishtlindje.
A u apin ata fëmijëvet peshqeshe për Krishtlindje?
Po, ata u apin fëmijëvet peshqeshe për Krishtlindje.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

GARAZHI IM

1. Ku e lêni automobilin natën?
2. E lâ jashtë, n'anë të rrugës.

3. Ju paskeni garazh. Pse nuk e futni mbrendë?
4. Nuk e fus sepse s'ka vend: âsht plot me plaçka.

5. Çfarë plaçkash mbani në garazh?
6. Plaçkat e palame, lojnat e fëmijëvet dhe veglat e punës.

7. Ku i vêni plaçkat e palame?
8. I fusim në nji arkë që lâmë në nji qoshe.

9. Ku i vêni veglat e punës?
10. Ca i vê mbi nji tryezë e ca i var në múr. Kam edhe shumë libra.

11. Libra? Aq shumë paskeni sa mos me mujtë me i vû në dhomën e pritjes?
12. Shumë kam. I kam prû nga Shqipnija.

13. Çfarë librash janë? Çfarë teme trajtojnë?
14. Janë romane, libra historije, gjeografije, matematike etj.

15. A keni ndonji gramatikë shqipe?
16. Kam nji të ré; e kam lânë n'automobil. A doni me e lexue?

17. Ju falem nderës, por mâ parë duhet të ju bijmë ata që ju kemi marrë huá.
18. Mund t'i bini kur të dishroni.

19. Kam ndigjue se zoja juej punon; kush e bje atê në shtëpí?
20. Unë e bij kur këthehem nga puna.

21. Nji gjâ tjetër. Me çka u-merrshi kur ishi në Shqipní?
22. Para luftës u-merrshem me tregtí; mbas luftës kam qenë në burg.

23. Pse ju futën në burg?
24. Nuk mujta me pague taksat e rânda që më kishin vû.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ALBANIAN - 45



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

Idiomatic Translation-Përkëthim i Lirë

1. Where do you leave your car at night?
2. I leave it outside, at the curb.

3. You have a garage. Why don't you put it inside?
4. I don't put it inside because there is no room; it is full of stuff.

5. What kind of things do you keep in the garage?
6. Dirty clothes and linen, my children's toys, work tools ....

7. Where do you keep your dirty clothes and linen?
8. We put them in the clothes hamper that we keep in a corner.

9. Where do you keep your work tools?
10. I keep some of them on my work bench and some others I hang on the wall. I have also many books.

11. Books? You have so many that you are not able to keep them in the living room?
12. I have many. I brought them from Albania.

13. What kind of books are they? What subjects do they treat?
14. I have novels, history, geography, mathematic textbooks, etc.

15. Do you have any Albanian grammar textbook?
16. I have a new one; I have it in my car. Do you want to read it?

17. Thank you, but first we have to bring back those that we borrowed from you.
18. You may return them whenever you want.

19. I have heard that your wife works; who brings her home?
20. I take her when I return from work.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

21. Another thing. What kind of work did you do when you were in Albania?
22. Before the war I was a merchant; after the war in prison.

23. Why did they put you in prison?
24. I was not able to pay the heavy taxes that they wanted.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

THE ADMIRATIVE MOOD

This particular mood is a pecularity of the Albanian language. It is used to show admiration, amazement, astonishment, as a form of exclamation but not in narration.

Examples:

I happen to see an old friend, after an absence of many years; I see also that he has gained weight, which constitutes a surprise to me. So, I may exclaim to my friend:

Oh, sa qenke trashë!
(You must have gained weight!)

I am supposed to go to a party. I take a bath, shave and then go into my room to dress. I open the drawer to get a clean shirt, but there are none. I am very disappointed and I may exclaim:

Po tash? S'paskam këmishë të lame!
(Why, I haven't got a clean shirt!)

I buy an expensive watch. The next day my alarm clock wakes me up at 6 o'clock, I look at my new watch and to my surprise it is running 10 minutes late.

Mos bre! Shkueka mbrapa!
(Oh No! It's running slow!)

Formation of the admirative mood:

The present admirative is formed by suffixing kam, ke, ka, kemi, keni, kan to the verb in the infinitive (ë is omitted).

Examples: (following page)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me qenë	me pasë	me shkue	me fjetë	me u-lá
qenkam	paskam	shkuekam	fjetkam	u-lakam
qenke	paske	shkueke	fjetke	u-lake
qenka	paska	shkueka	fjetka	u-laka
qenkemi	paskemi	shkuekemi	fjetkemi	u-lakemi
qenkeni	paskeni	shkuekeni	fjetkeni	u-lakeni
qenkan	paskan	shkuekan	fjetkan	u-lakan

Remarks: Some verbs may also form the present admirative by suffixing kam, ke, etc. to the stem of the 2nd person plural of the present indicative.

Examples:

me ndejtë		
ndejtkam	or	rrikam
ndejtke		rrike
ndejtka		rrika
ndejtkemi		rrikemi
ndejtkeni		rrikeni
ndejtkan		rrikan

me folë		
folkam	or	flitkam
folke		flitke
folka		flitka
folkemi		flitkemi
folkeni		flitkeni
folkan		flitkan

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me pá		
pakam	or	shifkam
pake		shifke
paka		shifka
pakemi		shifkemi
pakeni		shifkeni
pakan		shifkan

The perfect admirative is formed by the present admirative of the auxiliary me pasë for the active verbs and me qenë for the passive verbs, plus the past participle of the verb in question.

Examples:	me shkue	me u-lá
	paskam shkue	qenkam lá
	paske shkue	qenke lá
	paska shkue	qenka lá
	paskemi shkue	qenkemi lá
	paskeni shkue	qenkeni lá
	paskan shkue	qenkan lá

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

THE IMPERFECT OF THE INDICATIVE MOOD OF THE PASSIVE VERB

(In Lesson 44 Conjugation A was discussed and in this Lesson we will deal with Conjugation B)

By adding the prefix u- to the imperfect of an active verb, the imperfect (Conjugation B) of the corresponding passive verb is obtained.

Examples:	me lá	me u-lá
	lajshem	u-lajshem
	lajshe	u-lajshe
	lante	u-lante
	lajshim	u-lajshim
	lajshi	u-lajshi
	lajshin	u-lajshin

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 45
PART IV
GRAMMAR DRILL

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

1. A i lêni ju librat në klasë?
Po, unë i lâ librat në klasë.
A e lâ unë automobilin n'anë të rrugës?
Po, ju e lêni automobilin n'anë të rrugës.
A e lê ai djalin në shtëpí?
Po, ai e lê djalin në shtëpí.
A i lêni ju librat mbi tryezë?
Po, na i lâmë librat mbi tryezë.
A i lâmë na në garazh plaçkat e palame?
Po, ju i lêni në garazh plaçkat e palame.
Në ç'vend i lânë ata plaçkat e palame?
Ata i lânë plaçkat e palame në garazh.

A e lêni ju vajzën të shkojë në kinema vetëm?
Jo, unë nuk e lâ vajzën të shkojë në kinema vetëm.
Kush nuk e lê vajzën të shkojë në kinema vetëm?
Ju nuk e lêni vajzën të shkojë në kinema vetëm.
Po ai, a e lê vajzën të shkojë në kinema vetëm?
Jo, as ai nuk e lê vajzën të shkojë në kinema vetëm.
A i lêni ju nxânsit të dalin nga klasa kur të duen?
Jo, na nuk i lâmë nxânsit të dalin nga klasa kur të duen.
Cilët nuk i lânë nxânsit të dalin nga klasa kur të duen?
Ju nuk i lêni nxânsit të dalin nga klasa kur të duen.
A i lânë ata fëmijët me luejtë në rrugë?
Jo, ata nuk i lânë fëmijët me luejtë në rrugë.

2. A i vêni ju plaçkat e dhomës në rregull çdo mëngjes?
Po, unë i vê plaçkat e dhomës në rregull çdo mëngjes.
Kush i vê plaçkat e dhomës në rregull çdo mëngjes?
Ju i vêni plaçkat e dhomës në rregull çdo mëngjes.
A i vê edhe ai plaçkat e dhomës në rregull çdo mëngjes?
Po, edhe ai i vê plaçkat e dhomës në rregull çdo mëngjes.
A i vêni ju fëmijët me fjetë heret?
Po, na i vêmë fëmijët me fjetë heret.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kush i vê fëmijët me fjetë heret?
Ju i vêni fëmijët me fjetë heret.
A i vênë ata fëmijët me fjetë heret?
Po, ata i vênë fëmijët me fjetë heret.

A i vûtë ju plaçkat e dhomës në rregull?
Po, unë i vûna plaçkat e dhomës në rregull.
Kush i vûni plaçkat e dhomës në rregull?
Ju i vûtë plaçkat e dhomës në rregull.
A i vûni ai plaçkat e dhomës në rregull?
Po, ai i vûni plaçkat e dhomës në rregull.
A i vûtë ju plaçkat e dhomës në rregull?
Po, na i vûmë plaçkat e dhomës në rregull.
A i vûmë na plaçkat e dhomës në rregull?
Po, ju i vûtë plaçkat e dhomës në rregull.
A i vûnë ata fëmijët me fjetë heret?
Po, ata i vûnë fëmijët me fjetë heret.

3. A e futni ju automobilin në garazh çdo mbrâmje?
Po, unë e fus automobilin në garazh çdo mbrâmje.
Kush e fut automobilin në garazh çdo mbrâmje?
Ti e fut automobilin në garazh çdo mbrâmje.
Po ai, a e fut automobilin në garazh çdo mbrâmje?
Po, edhe ai e fut automobilin në garazh çdo mbrâmje.
A i futni ju plaçkat e palame në nji arkë?
Po, na i fusim plaçkat e palame në nji arkë.
A i fusim na plaçkat e palame në nji arkë?
Po, ju i futni plaçkat e palame në nji arkë.
Cilët i fusin plaçkat e palame në nji arkë?
Ata i fusin plaçkat e palame në nji arkë.

4. A e bini ju gruen në punë çdo ditë?
Po, unë e bij gruen në punë çdo ditë.
Kush e bje gruen në punë çdo ditë?
Ju e bini gruen në punë çdo ditë.
A e bje ai Zotni Lubonjën në shkollë çdo ditë?
Po, ai e bje Zotni Lubonjën në shkollë çdo ditë.
A i bini librat me vete kur vîni në shkollë?
Po, na i bijmë librat me vete kur vîjmë në shkollë.
A i bijmë na librat me vete kur vîjmë në shkollë?
Po, ju i bini librat me vete kur vîni në shkollë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A i bijnë ata me vete veglat e punës kur vîjnë me punue?
Po, ata i bijnë me vete veglat e punës kur vîjnë me punue.

5. A u-rruejshi ju çdo ditë kur ishi në katund?
Po, unë u-rruejshem çdo ditë kur ishem në katund.
A u-rruejshem unë çdo ditë kur ishem në katund?
Po, ju u-rruejshi çdo ditë kur ishi në katund.
Kush u-rruente çdo ditë kur ishte në katund?
Ai u-rruente çdo ditë kur ishte në katund.
A u-rruejshi ju çdo ditë kur ishi në katund?
Po, na u-rruejshim çdo ditë kur ishim në katund.
Cilët u-rruejshin çdo ditë kur ishin në katund?
Ju u-rruejshi çdo ditë kur ishi në katund.
A u-rruejshin ata çdo ditë kur ishin në mal për verim?
Po, ata u-rruejshin çdo ditë kur ishin në mal për verim.

6. A u-lajshi ju me ujë të nxehët në dimën?
Po, unë u-lajshem me ujë të nxehët në dimën.
Kush u-lante me ujë të nxehët në dimën?
Ju u-lajshi me ujë të nxehët në dimën.
Po ai, a u-lante me ujë të nxehët në dimën?
Po, edhe ai u-lante me ujë të nxehët në dimën.
A u-lajshi me ujë të nxehët apo me ujë të ftofët në dimën?
Na u-lajshim me ujë të nxehët.
A u-lajshim na me ujë të nxehët në dimën?
Po, ju u-lajshi me ujë të nxehët në dimën.
Cilët u-lajshin me ujë të nxehët në dimën?
Ata u-lajshin me ujë të nxehët në dimën.

7. A ka vend edhe për jú n'automobil?
Jo, për mue s'ka vend.
A ka vend edhe për mue n'automobil?
Jo, për jú s'ka vend; më vjen shumë keq.
Për kê s'ka vend n'automobil?
Për Zotní Skraparin s'ka vend n'automobil.
A ka vend në hotel për jú?
Jo, âsht plot; s'ka mâ vend për né.
A ka vend në hotel për né?
Jo, âsht plot; s'ka mâ vend për jú.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A ka vend në hotel për ata?
Jo, âsht plot; s'ka mâ vend për ata.

8. A merrni ndonjiherë të holla huá nga banka?
Po, unë marr të holla huá nga banka kur kam nevojë.
Kush merr të holla huá nga banka, zakonisht?
Zakonisht, ata që blejnë shtëpí marrin të holla huá nga banka.
A marr unë të holla huá nga shokët?
Po, ju merrni të holla huá nga shokët.
A merr ai të holla huá nga shokët e dhomës?
Po, ai merr të holla huá nga shokët e dhomës.
A merrni ju të holla huá nga shokët?
Po, na marrim të holla huá nga shokët nganjiherë.

A marrim na ndonji herë të holla huá nga shokët?
Po, ju merrni nganjiherë të holla huá nga shokët.
A marrin ata të holla huá nga banka?
Po, ata marrin të holla huá nga banka.

A u epni libra huá shokëvet?
Po, unë u ap libra huá shokëvet.
Kush u ep libra huá shokëvet?
Ju u epni libra huá shokëvet.
A u ep ai libra huá shokëvet?
Po, ai u ep libra huá shokëvet.
Çka u epni huá ju shokëvet?
Na u apim libra huá shokëvet.
Kush u ep libra huá shokëvet?
Ju u epni libra huá shokëvet.
Po ata, a u apin libra huá shokëvet?
Po, edhe ata u apin libra huá shokëvet.

9. Me çka merreni ju?
Unë merrem me tregtí.
Me çka merrem unë?
Ju merreni me bujqësí.
Kush merret me tregtí?
Ai merret me tregtí.
A merreni ju me tregtí?
Po, na merremi me tregtí.
Me çka merremi na?
Ju merreni me bujqësí.
A merren ata me tregtí?
Po, ata merren me tregtí.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

10. A i ka vû shteti taksa të rânda Zotnî Trebishtit?
Po, shteti i ka vû taksa të rânda Zotnî Trebishtit.
Kush i ka vû taksa të rânda Zotnî Trebishtit?
Shteti i ka vû taksa të rânda Zotnî Trebishtit.
Sa taksa ju ka vû shteti jû?
Nuk më ka vû taksa të rânda sepse kam shumë fëmijë.

11. A e kanë futë Osman Balën në burg për vjedhje?
Po, Osman Balën e kanë futë në burg për vjedhje.
Kush e ka futë në burg Osman Balën?
Qeverija e ka futë në burg Osman Balën.
Kê ka futë në burg qeverija?
Osman Balën e ka futë në burg qeverija.
Pse e ka futë qeverija në burg Osman Balën?
Qeverija e ka futë Osman Balën në burg për vjedhje.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 45
PART V

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

TRANSLATION EXERCISE

RRETHI I SHKODRËS

Rrethi i Shkodrës, krejt në verí të Shqipnís, âsht i mbuluem me male shumë të nalta; këto male quhen Alpet (Alps) e Shqipnís së Veriut. Mali i Jezercës (2700 m.), mbas Korabit (2764 m.) âsht mali mâ i naltë i vendit tonë. Ky rreth ka edhe trí fusha shumë pjellore që gjinden përreth qytetit të Shkodrës; këto janë: Fusha e Shtoit, ajo e Zadrimës dhe e Bregut të Bunës. Në këto fusha prodhohen drithna e duhan.

Rrethi i Shkodrës âsht nji nga rrethet mâ të pasuna me ujna; nji e treta e Liqenit të Shkodrës, e liqenit mâ të madh në Ballkan (360 km^2) gjindet në këtë rreth. Këtu rrjedhin katër lumej: Buna që bashkon Liqenin e Shkodrës me detin Adriatik, Drinasi, Drini dhe lumi i vogël Kiri.

Shkodra, nji qytet i hapët me rrugë të drejta, me shtëpí të mëdhaja të rrethueme (surrounded) me mure të nalta, âsht qendra e këtij rrethi. Mbas Shkodrës për rândësí vjen qyteti i vogël i Lezhës (quhet edhe Lesh; në Kohën e Romakëvet quhesh Alessio). Shumë kohë mâ parë Lezha ishte skele, por sot

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ndodhet larg detit; qyteti âsht i ndërtuem në krahun e majtë (left) të Drinit. Asht nji ndër qytetet mâ të vjetra; historija flet për tê si nji qendër kulture të dorës së parë, por sot nuk e ka mâ rândësín që ka pasë.

An old woman was upset when the young doctor said that nothing was wrong with her health.

"Don't tell me there is nothing wrong, young man. I was in bad health before you were born," replied the lady.

A Russian teacher asked a pupil, "Who were the first humans?"

"Adam and Eve," he answered. (Adem, Hava or Eva)

"And what nationality were they?"

"Russian, of course."

"How do you know they were Russians?"

"That's easy," responded the pupil. "They had no house to live in, no clothes to wear, one apple for both of them and they said they were living in paradise (parajsë)."

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 45
PART VI
READING TEXT

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

Proverb: Mos e lê punën e sotshme për nesër

Zotní Trebishti âsht Shqiptár. Bashkë me gruen ka ardhë ca vjet mâ parë për të jetue këtu n'Amerikë. Jetojnë në nji qytet të vogël të Kalifornís. Punojnë që të dy dhe banojnë në nji shtëpí mjaft të bukur. Zotní Trebishti e ka blé shtëpín mbas trí vjetësh që ka ardhë këtu.

Shtëpija ka dý dhoma fjetje, nji dhomë pritje dhe nji kuzhinë. Si çdo shtëpí tjetër n'Amerikë, edhe shtëpija e Zotní Trebishtit ka nji garazh. Garazhi, si e dijmë, përdoret për të mbajtë automobilin, sidomos natën. Edhe Zotní Trebishti ka [illegible]t mobil, të cilin e përdor mâ shumë për të shkue e për t'u-këthye nga puna. Automobilin nuk e fut në garazh, por e lê jashtë, n'anë të rrugës, sepse s'ka vend në garazh. Garazhi i tij âsht plot me plaçka të palame, lojna fëmijësh, vegla pune etj. Plaçkat e palame i fusin në nji arkë që e lânë në nji qoshe të garazhit. Ca prej veglave të punës i vênë mbi tryezë e ca i varin në mûr. Zotní Trebishti ka shumë libra, si romane, libra historije, gjeografije, matematike etj. e ndër ta edhe nji gramatikë të

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

rê të gjuhës shqipe. Pothuej të gjithë këta libra i ka prû nga Shqipnija. Mbasi s'ka mâ vend për ta në dhomën e pritjes, shumë prej tyne i mban në garazh. Disa prej libravet Zotní Trebishti i a ka dhânë huá nji miku.

Zotní Trebishti para luftës dhe gjatë luftës, kur ishte në Shqipní, merresh me tregtí. Mbas luftës e futën në burg për arësye se s'qe i zoti të paguente taksat e rânda që i kishte vû shteti.

QUESTIONS - PYETJE

1. Ç'kombësije âsht Zotní Trebishti?
2. Kur ka ardhë n'Amerikë Zotní Trebishti?
3. Me kê ka ardhë n'Amerikë?
4. Ku jetojnë Zotní Trebishti dhe grueja e tij?
5. A e ka marrë me qirá apo e ka blé shtëpín Zotní Trebishti?
6. Kur e ka blé shtëpín?
7. Sa dhoma ka shtëpija?
8. Çka tjetër ka shtëpija përveç dhomavet të fjetjes, dhomës së pritjes dhe kuzhinës?
9. Për çka përdoret, zakonisht, garazhi?
10. Për çka e përdor mâ shumë automobilin Zotní Trebishti?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

11. Ku e lê automobilin?
12. Pse nuk e fut në garazh?
13. Me çfarë plaçkash âsht plot garazhi?
14. Ku i fusin plaçkat e palame?
15. Ku e lânë arkën me plaçka të palame?
16. Ku i vênë disa prej veglavet të punës?
17. Po disa tjera ku i varin?
18. Çfarë librash ka Zotni Trebishti?
19. Ku i mban këta libra?
20. Pse nuk i mban librat në dhomën e pritjes?
21. Kujt i a ka dhânë huá disa prej libravet?
22. Me çka merresh në Shqipní Zotni Trebishti?
23. Kur merresh me tregt?
24. Çka i ngjau Zotni Trebishtit mbas luftës?
25. Pse e futën në burg?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 45
PART VII
HOMEWORK

PJESA E SHTATË
DETYRË SHTËPIJE

Përgjegjuni këtyne pyetjeve:

1. Pse nuk e lêni qenin me hŷ mbrendë në shtëpí?
2. Ku i lânë njerzit kapelat kur hŷjnë në kinema?
3. Për se na shërben syza?
4. Pse marrin njerzit të holla huá?
5. Çfarë librash ju pëlqen me lexue?
6. Çfarë gjânash fusim në xhep?
7. Me çka i bini librat në klasë: me çantë, apo në dorë?
8. Me çka merret bujku?
9. Çka varim në mûr, zakonisht?
10. Cilët njerëz fusin në burg?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 45
PART VIII
VOCABULARY

PJESA E TETË
FJALORI

anë, -a anë, -t	(f.)	side, edge; region
arkë, -a arka, -t	(f.)	box, chest, case
burg, -u burgje, -t	(m.)	prison, jail
garazh, -i garazhe, -t	(m.)	garage
gramatikë, -a gramatika, -t	(f.)	grammar
gjeografí, -ja	(f.)	geography
historí, -ja	(f.)	history
huá, -ja huana, -t	(f.)	loan
me lânë (unë lâ)	(v.)	to leave, let, allow, abandon; to quit (drinking or smoking); to park; to grow (a mustache or a beard)
matematikë, -a	(f.)	mathematics
múr, -i mure, -t	(m.)	wall
i, të palamë e, të palame	(adj. m.&f.)	unwashed
plaçka të palame	(f.)	dirty clothes, dirty linen
plot	(adv.)	full, filled
me prû (unë bij)	(v.)	to bring

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

roman, -i romane, -t	(m.)	novel
taksë, -a taksa, -t	(f.)	tax, fee
temë, -a tema, -t	(f.)	theme, subject
me trajtue (unë trajtoj)	(v.)	to treat (not medically)
tregtí, -ja	(f.)	trade, business, commerce
vegël, vegla vegla, -t	(f.)	instrument, tool, device
me vû (unë vê)	(v.)	to put, place; to install; to assign

NOTES:

ka (s'ka) vend	there is (isn't) room
me vû taksë	to tax
me marrë hua	to borrow
me dhânë hua	to lend

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 46
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. A i mbyllin tregtarët dyqanet mbas prendimit?
Po, tregtarët i mbyllin dyqanet mbas prendimit.
A mbyllen dyqanet mbas prendimit?
Po, dyqanet mbyllen mbas prendimit.
Në ç'orë mbyllen dyqanet në Monterey?
Në Monterey dyqanet mbyllen n'orën 5.30.
Në ç'orë mbyllen zyrat?
Zyrat mbyllen n'orën 5.

A i hapin tregtarët dyqanet n'orën 8?
Po, tregtarët i hapin dyqanet n'orën 8.
A hapen dyqanet n'orën 8?
Po, dyqanet hapen n'orën 8.
Kur hapen zyrat?
Edhe zyrat hapen n'orën 8.

A e sjellin kafen me tabake në Shqipní?
Po, në Shqipní kafen e sjellin me tabake.
A sillet kafja me tabake në Shqipní?
Po, në Shqipní kafja sillet me tabake.
A sillet edhe nji gotë ujë me kafe?
Po, me kafe sillet edhe nji gotë ujë.

A e hanë shumë njerëz pulën me duer?
Po, shumë njerëz e hanë pulën me duer.
A hahet pula me duer?
Po, pula hahet me duer.
Me çka pihet kafja?
Kafja pihet me filxhan.
Me çka hahet supa?
Supa hahet me lugë.

2. A âsht e mundun me pí ujë deti?
Jo, nuk âsht e mundun me pí ujë deti.
A pihet uji i detit?
Jo, uji i detit nuk pihet.
A pihet uji i burimit?
Po, uji i burimit pihet.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A âsht e mundun me e lexue shkrimin e mjekut?
Jo, shkrimin e mjekut nuk âsht e mundun me e lexue.
A lexohet shkrimi i mjekut?
Jo, shkrimi i mjekut nuk lexohet.
Kush mundet me e lexue shkrimin e mjekut?
Farmacisti mundet me e lexue shkrimin e mjekut.

A âsht e mundun me udhëtue natën pa drita?
Jo, nuk âsht e mundun me udhëtue natën pa drita.
A udhëtohet natën pa drita?
Jo, natën pa drita nuk udhëtohet.

A âsht e mundun me fjetë kur bân të nxehët?
Jo, kur bân të nxehët nuk âsht e mundun me fjetë.
A flêhet kur bân të nxehët?
Jo, kur bân të nxehët nuk flêhet.
A flêhet mirë kur âsht fresk?
Po, kur âsht fresk flêhet mirë.

3. Nji mollë âsht e ndame në dý pjesë:
E sata pjesë âsht njâna?
Njâna âsht gjymsa (e mollës).
Po tjetra?
Tjetra âsht gjymsa tjetër (e mollës).

Nji mollë âsht e ndame në trí pjesë:
E sata pjesë âsht njâna?
Njâna âsht nji e treta (e mollës).
Po dý tjerat?
Dý tjerat janë dý të tretat (e mollës).

Nji mollë âsht e ndame në katër pjesë:
E sata pjesë âsht njâna?
Njâna âsht nji e katërta.
Po tjerat?
Tjerat janë trí të katërtat.
A quhet nji e katërta çerek?
Po, nji e katërta quhet çerek.
A quhen trí katërtat tre çerekë?
Po, trí të katërtat quhen tre çerekë.

4. A keni ju automobil?
Po, unë kam automobil.
A jeni ju i zoti i automobilit?
Jo, unë nuk jam i zoti i automobilit.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Pse, i kujt âsht automobili?
Automobili âsht i babës.
A âsht baba, pra, i zoti i automobilit?
Po, baba âsht i zoti i automobilit.

A jeni ju i martuem?
Po, unë jam i martuem.
Me kë jetoni ju?
Unë jetoj me gruen, babën dhe nânën.
Kush âsht i zoti i shtëpís?
Unë jam i zoti i shtëpís.
Pse jeni ju dhe jo baba i zoti i shtëpís?
Sepse baba âsht plak.
E kujt âsht shtëpija ku jetoni?
Asht e nji oficeri.
A âsht, pra oficeri i zoti i shtëpís ku jetoni?
Po, oficeri âsht i zoti i shtëpís ku jetoj.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 46
PART II
DIALOGUE

CA NGA ZAKONET TONA

1. Dishroj me dijtë diçka mbi jetën e përditëshme të shqiptarëvet.
2. Mirë! Çka doni me dijtë?

3. Çka hanë shqiptarët në mëngjes?
4. Përshesh me qumësht, byrek, vê surbull; këto janë disa nga gjellët kryesore.

5. Kam ndigjue se kudo n'Europë njerzit hanë mâ shumë në drekë.
6. Edhe në Shqipní. Përveç kësaj, darka hahet mâ vonë se këtu.

7. Çfarë gjellësh hahen në drekë?
8. Supë, nji gjellë me mish, djathë, âmbëlsinë, pemë e në fund shërbehet kafja.

9. Po në darkë?
10. Kos, fërgesë, sallatë etj.

11. Cila âsht gjella mâ e zakonshme në Shqipní?
12. Mishi me groshë dhe specat e domatet e mbushuna.

13. Kur nji njerí ftohet për bukë, çka i sjell të zotit ase zojës së shtëpís?
14. Asgjâ. Fëmijëvet mund t'u sjelli sheqerna ase t'u fali të holla.

15. Ç'fé ka pjesa mâ e madhe e popullsís?
16. Afërsisht dý të tretat e popullsís janë muslimanë.

17. Ç'festa fetare kanë ata?
18. Kanë Bajramin e Madh dhe Bajramin e Vogël.

19. A festohet ditëlindja në Shqipní?
20. Shumë rrallë. Të krishtenët festojnë ditën e emnit.

21. Po përvjetori i martesës, a festohet?
22. Edhe këtë festë pakkush e feston.

23. Në ç'moshë martohen shqiptarët?
24. Zakonisht, kur kanë mbarue shkollën ase kanë zânë punë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ALBANIAN



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 46

PJESA E DYTË — PART II

DIALOGU — DIALOGUE

SOME OF OUR CUSTOMS

Idiomatic Translation-Përkëthim i Lirë

1. I would like to know something about the Albanians' everyday life.
2. Fine. What would you like to know?

3. What do Albanians have for breakfast.
4. Soaked bread in milk, "byrek," soft boiled eggs; these are some of the main foods.

5. I have heard that everywhere in Europe people eat more at lunch.
6. In Albania also. Besides that, they have dinner later than here.

7. What do they eat at lunch?
8. Soup, one dish with meat, cheese, dessert, fruit and finally coffee is served.

9. What about at dinner?
10. Yogurt, eggs fried with minced meat, salads, etc.

11. What is the common dish in Albania?
12. Meat with beans and stuffed peppers and tomatoes.

13. When someone is invited for a meal, what does he bring to the host or hostess?
14. Nothing. He may give candies to the children or offer them money.

15. What is the religion of the largest part of the population?
16. Almost two thirds of the population are moslems.

17. What are their religious holidays
18. The Greater Bairam and the Lesser Bairam.

19. Are birthdays celebrated in Albania?
20. Very seldom. Christians celebrate their saint's day.

21. What about the wedding anniversary, is it celebrated?
22. Few people celebrate it.

23. When do Albanians get married?
24. Usually when they finish school or have a job.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 46
PART III

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

GRAMMAR ANALYSIS

USAGE OF PASSIVE VERBS

(3rd Person, Singular and Plural, continuation of Grammar Analysis, Lesson 43, paragraph 2.)

Two more features of the passive verbs remain to be dealth with. These features present no difficulty as far as form is concerned, but the content is quite different.

a. When an action is performed by a majority of individuals and it is more or less considered as a habit, instead of the active verb the 3rd person of the passive verb is used.

Examples:

Në Shqipní darka hahet vonë.
(The Albanians have supper late.)

The same statement could be construed as follows:

Në Shqipní njerzit hanë darkë vonë.
(In Albania people eat supper late.)

Letrat shkruhen me pênd̂ë.
(Letters are written with a pen.)

The same statement could be construed as follows:

Âsht zakon me i shkrue letrat me pênd̂ë.
(It is customary to write letters with a pen.)

Thohet se sivjet do të bjerë shumë shí.
(People say that this year we are going to have a lot of rain.)

Në klasë nuk pihet duhan.
(We do not smoke in the classroom.)

The same statement could be construed as follows:

Nuk âsht zakon me pí duhan në klasë.
(It is not customary to smoke in the classroom.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Në kishë nuk flitet.
(People do not talk in church.)

The same statement could be construed as follows:

Nuk âsht zakon me folë në kishë.
(It is not customary to talk in church.)

b. When an expression denotes possibility or impossibility the 3rd person of the passive verb concerned is used. This feature of the passive verb corresponds to a certain extent to the English adjectives ending in -ble, i.e. drinkable, palatable, likable, etc.

Examples:

Gjella pa krypë nuk hahet.
(Food without salt cannot be eaten.)
(Food without salt is not eatable.)

Ky ujë nuk pihet.
(This water is not drinkable.)

Ky lum nuk kalohet.
(People cannot wade this river.)

NOUNS EXPRESSING FRACTIONS

a. Fractions are expressed as in English, with a cardinal number for the numerator and an ordinal for the denominator, except for $\frac{1}{2}$ (nji gjymës). Taking the fraction as a noun, the noun is in the feminine gender, because it refers to a part, or parts of tanësi (whole), which is a feminine noun.

Examples:

$\frac{1}{3}$	nji e treta	one third
$\frac{1}{4}$	nji e katërta	one fourth

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

$\frac{1}{5}$	nji e pesta	one fifth
$\frac{1}{10}$	nji e dheta	one tenth

When the numerator is larger than one, the denominator is in the definite plural.

$\frac{2}{3}$	dý të tretat	two thirds
$\frac{2}{5}$	dý të pestat	two fifths
$\frac{3}{4}$	trí të katërtat	three fourths
$\frac{3}{5}$	trí të pestat	three fifths

b. Declension--The numerator is not declined. When the fraction is used as a noun the denominator is declined regularly, following the pattern of the declension of the feminine nouns.

Examples:

Nom.	nji e treta	dý të tretat
Gen.	i, e, të nji së tretës	i, e, të dý të tretavet
Dat.	nji së tretës	dý të tretavet
Ac.	nji të tretën	dý të tretat
Abl.	prej nji së tretës	prej dý të tretavet

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

LESSON 46
PART IV
GRAMMAR DRILL

1. (a.)

Zakonisht, dreka hahet n'orën 12.

Çka hahet n'orën 12: dreka apo darka?
Në ç'orë hahet dreka, zakonisht?

Uji i ndytë, në qoftë se pihet, sjell sëmundje.

Cili ujë sjell sëmundje në qoftë se pihet?
Në ç'rasë sjell sëmundje uji i ndytë?
Çka sjell uji i ndytë në qoftë se pihet?

Ambëlsinat shërbehen në fund të drekës ase të darkës.

Çka shërbehet në fund të drekës ase të darkës?
Kur shërbehen âmbëlsinat?

Pashkët nuk festohen më si festa zyrëtare në Shqipní.

Cilat festa nuk festohen më si festa zyrëtare në Shqipní?
Në cilin shtet Pashkët nuk festohen më si festa zyrëtare?

Tregohet se gjatë luftës shumë fëmijë janë rritë pa qumësht.

Çka tregohet?
Tregohet se në ç'kohë shumë fëmijë janë rritë pa qumësht?
Pa çka janë rritë shumë fëmijë?

(b.)

Kur bân shumë të nxehët nuk flêhet mirë.

Kur nuk flêhet mirë?
Çka ngjân kur bân të nxehët?
Qysh nuk flêhet kur bân të nxehët?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Në spital nuk shkohet për vizitë çdo orë të ditës.

Ku nuk shkohet për vizitë çdo orë të ditës?
Për çka nuk shkohet në spital çdo orë të ditës?
A e dini në ç'orë të ditës shkohet në spital për vizitë?

2. (a.)

Nji e katërta e orës ka 15 minuta dhe quhet nji çerek ore.

Si quhet nji e katërta e orës?
Sa minuta ka nji e katërta e orës?

Dje bleva nji âmbëlsinë dhe hangra nji të katërtën.

Kush bleu nji âmbëlsinë dhe hangri nji të katërtën?
Sa âmbëlsina bleva dhe sa hangra?

Gati nji e treta e nxânësvet në këtë shkollë studjojnë rusisht.

Sa nxânës studjojnë rusisht në këtë shkollë?
Në cilën shkollë studjojnë rusisht gati nji e treta e nxânësvet?
Ç'gjuhë studjojnë gati nji e treta e nxânësvet?

Bleva nji automobil të ri dhe dhash nji të tretën e të hollavet në dorë.

Çka bleva dhe sa dhash në dorë?
Sa dhash në dorë për automobilin që bleva?

(b.)

Dje munguen dý të tretat e nxânësvet.

Sa nxânës munguen dje?
Kur munguen dý të tretat e nxânësvet?

Ky qylym mbulon trí të katërtat e dhomës.

Çka mbulon trí të katërtat e dhomës?
Sa pjesë të dhomës mbulon ky qylym?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Pothuej katër të pestat e botës janë të mbulueme me ujë.

Sa pjesë të botës janë të mbulueme me ujë?
Me çka janë të mbulueme katër të pestat e botës?

3. A ka Monterej ndonji gazetë të përditëshme?
Si quhet gazeta e përditëshme e Monterejt?

A keni lexue ndonji gjâ mbi jetën e Linkolnit?
Sa herë keni qenë i sëmundë në jetën tuej?

Si ju pëlqejnë vét: të fërgueme apo surbull?
A hani ndonji herë vé surbull?

Si quhet gjella e bâme me vé të fërgueme me mish?
Cila âsht gjella mâ e zakonshme në Shqipní?
Cila âsht gjella mâ e zakonshme n'Amerikë?

Pse u pëlqejnë fëmijëvet sheqernat?
A âsht mirë për dhâmbët me hangër shumë sheqerna?

A âsht Zotní Berati i krishtenë?
Ç'fé ka Zotní Berati?
A âsht ai fetár?
Sa festa fetare festohen n'Amerikë?
Kur e keni ju ditëlindjen?
A âsht 4 Korriku përvjetor?
Ç'moshë keni ju?
Ç'moshë duhet të keni kur hŷni n'ushtrí?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 46
PART V

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

TRANSLATION EXERCISE

Rrethi i Elbasanit gjindet në Shqipnía e Mesme. Pjesa më e madhe e këtij rrethi âsht e mbulueme me male të nalta dhe të pasuna me qymyr guri (coal).

Në fushën e ekonomís, përveç drithnavet, rândësi të madhe ka prodhimi i duhanit, i orizit, i pambukut dhe i ullînit. Kombinati i drunit âsht fabrika më e madhe e këtij rrethi, kurse Cërriku, nji qytet i rí, âsht sot nji qendër e madhe e rafinerís së naftës (oil refinery).

Qyteti më i madh âsht Elbasani me afërsisht 30.000 banorë. Ky qytet âsht i njoftun në historín e Shqipnís si qendër kulture e arësimi (education). Qendra e qytetit âsht pazari, që ka dyqane të stilit të vjetër. Këtu rrugët janë shumë të ngushta. Shtëpít e Elbasanit janë të rrethueme me mure të nalta e me kopshte portokallash. Muret e kalâs (fortress), e ndërtueme prej venedikasvet dhe më vonë prej turqvet, kopshtet e gjâna e fushat me duhan i apin qytetit nji pamje të bukur.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Whenever possible, use passive verbs throughout the following translations:

1. In Albania stores open at 8 o'clock in the morning and close one hour after sunset. During the summer they close at 12 A.M. and open again at 5 P.M.
2. In 1581 Durrës was completely destroyed by an earthquake, and it was rebuilt fifty years later.
3. When it gets cold the animals go into caves, and the birds go to warmer places.
4. After 10 o'clock in the evening women are not seen in coffee houses, only men, generally bachelors are seen there.
5. Many European cities were destroyed during air raids, but today, no more destroyed houses, bridges or streets are seen.
6. Only in America people are invited for breakfast; in Albania people are invited for lunch or supper.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

LESSON 46
PART VI
READING TEXT

Proverb: Kur shkon mik lidhe pulën për kambe.

Zakonisht, Shqiptarët nuk hanë mëngjes, por pijnë vetëm kafe. Natyrisht, ka edhe njerëz që e kanë zakon me hangër mëngjes. Disa nga gjellët kryesore që hahen në mëngjes janë përsheshi me qumësht, byreku dhe vét surbull ase të fërgueme. Shumë gjellë që hahen n'Amerikë janë të zakonshme edhe në Shqipní, por shumë janë të ndryshme.

Në Shqipní, në drekë, zyrat dhe dyqanet rrijnë mbyllë 3 orë gjatë dimnit dhe 5 orë gjatë verës; njerzit pra kanë kohë me hangër shumë dhe me pushue. Dreka e rândë âsht nji gjâ e zakonshme kudo n'Evropë. Në darkë, përkundrazi, njerzit hanë pak dhe gjellë të lehta si p.sh. supë, fërgesë, sallatë, e tjera gjellë si këto.

Kur nji njerí ftohet për drekë ase për darkë nuk âsht zakon me i sjellë gjâ të zotit ase zojës së shtëpís. Vetëm fëmijëvet, po të dojë, u sjell sheqerna ase u fal të holla kur çohet me dalë.

Dý të tretat e shqiptarëvet janë muslimanë dhe nji e treta janë të krishtenë; ndër këta disa janë katolikë dhe tjerët janë ortodoksë. Muslimanët

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

kanë festat e tyne fetare, p. sh. Bajramin e Madh e Bajramin e Vogël; të krishtenët shqiptarë, si gjithë të krishtenët në botë, kanë si festa fetare Krishtlindjet dhe Pashkët. Të krishtenët festojnë edhe ditën e emnit; ditëlindja dhe përvjetori i martesës, zakonisht, nuk festohen në Shqipní.

Ndër katunde burrat martohen të rij, kurse ndër qytete martohen mbasi mbarojnë shkollën ase mbasi zânë punë. Vajzat martohen shumë të reja.

QUESTIONS - PYETJE

1. Zakonisht, kush nuk ha por pi vetëm kafe në mëngjes?
2. Çka e kanë shumë njerëz zakon me bâ në mëngjes?
3. Cilat janë disa nga gjellët kryesore që hahen në mëngjes?
4. Cilat gjellë janë të zakonshme edhe në Shqipní?
5. Në ç'vend zyrat dhe dyqanet rrijnë mbyllë në drekë trí orë gjatë dimnit dhe pesë orë gjatë verës?
6. Kur rrijnë mbyllë dyqanet në Shqipní?
7. Çka kanë kohë me bâ njerzit gjatë drekës në Shqipní?
8. Ku âsht dreka e rândë nji gjâ e zakonshme?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

9. Kur hanë njerzit pak e gjellë të lehta?

10. Çfarë gjellësh hanë njerzit në darkë?

11. Kur nji njerí ftohet për drekë ase për darkë, kujt nuk âsht zakon me i sjellë gjâ?

12. Kush u sjell fëmijëvet sheqerna ase u fal të holla kur çohet me dalë?

13. Kur u fal të holla fëmijëvet, kur vjen apo kur çohet me dalë?

14. Ç'fé kanë dý të tretat e shqiptarëvet?

15. Ç'fé kanë nji e treta e shqiptarëvet?

16. Ndër të krishtenë sa janë katolikë e sa janë ortodoksë?

17. Si quhen dý festat kryesore të muslimanëvet?

18. Kush ku si festa fetare Krishtlindjet dhe Pashkët?

19. Kush e feston ditën e emnit?

20. A festohet ditëlindja në Shqipní?

21. Cila festë tjetër, zakonisht, nuk festohet në Shqipní?

22. Në ç'moshë martohen burrat ndër katunde?

23. Kur martohen burrat ndër qytete?

24. Në ç'moshë martohen vajzat në Shqipní?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

PJESA E SHTATË
DETYRË SHTËPIJE

LESSON 46
PART VII
HOMEWORK

A. Translate the following sentences:

1. Mishi i derrit nuk hahet ndër vende muslimane.

2. Gjatë muejit të Ramazanit (Ramadan) as nuk hahet as nuk pihet prej orës 5 të mëngjesit deri në prendim.

3. Ky ujë âsht shumë i ndytë; nuk besoj se pihet.

4. Edhe në Shqipní, si n'Amerikë, gjâja e fundit që shërbehet âsht kafja; kjo sillet me tabake.

5. Në xhamí, kur muslimanët janë tue u-falë (to pray), nuk ndigjohet askush tue folë.

B. Answer the following questions:

6. Me ç'datë e keni ditëlindjen?

7. Cilat janë dý festat fetare kryesore të të krishtenëvet?

8. Sa gazeta të përditëshme ka qyteti ku keni lé dhe si quhen?

9. Tregoni çka hani ju në mëngjes.

10. Në ç'moshë fillojnë fëmijët me shkue në shkollë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 46
PART VIII
VOCABULARY

PJESA E TETË
FJALORI

Bajram, -i	(m.)	either of two Moslem festivals, one of which is at the end of Ramadan (the annual month of fast), while the other is 70 days later
byrek, -u byrekë, -t byreqe, -t	(m.)	a kind of pie filled with minced meat and/or vegetables
dita e emnit		saint's day (a day observed by a Christian in honor of the saint, whose name he bears)
dritë, -a drita, -t	(f.)	light
dý të tretat	(f.)	two thirds, 2/3
fé, -ja fé, -t	(f.)	religion, faith
me festue (unë festoj)	(v.)	to celebrate
me u-festue (festohet)	(v.)	to be celebrated
fetár, -e fetarë	(adj. m.&f.)	religious
fërgesë, -a fërgesa, -t	(f.)	fried eggs with minced meat; a dish made with fried cheese, tomatoes and peppers
i, të fërguem e, të fërgueme	(adj. m.&f.)	fried
me u-ftue (unë ftohem)	(v.)	to be invited

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.